



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / URED PREMIJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE
AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA
AGENCY ON GENDER EQUALITY



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

INTEGRIMI GJINOR NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR: NJË QASJE HAP PAS HAPI PËR KOMUNAT



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Asociacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

Financuar nga:
**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



SWEDEN



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
ZYRA E KRYEMINISTRIT / URED PREMIJERA
OFFICE OF THE PRIME MINISTER
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE
AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA
AGENCY ON GENDER EQUALITY



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

INTEGRIMI GJINOR NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR: NJË QASJE HAP PAS HAPI PËR KOMUNAT



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Asociacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

Financuar nga:
**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



FALËNDERIMET

Redaktore kryesore: Catarina Camarinhas, UN-Habitat

Kontribues kryesor: Arijeta Himaduna, UN-Habitat

Grupi mbështetës: Edona Hajrullahu, Agjencia për Barazi Gjinore; Fakete Kuka, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Fisnike Kelmendi, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Kadrije Myrtaj, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Leonora Selmani, Agjencia për Barazi Gjinore; Marija Radulovic, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Shqipe Arifaj, Asociacioni i Komunave të Kosovës

Recension: Cristina C. Vieira, Fakulteti i Psikologjisë dhe Shkencave të Edukimit - Universiteti i Coimbra-s, Portugali.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

711.4-055.1

711.4-055.2

Integrimi gjinor në planifikimin hapësinor: Një çasje hap pas hapi për komunat / Agjencia për Barazi Gjinore, 2015. – 40 f.: ilustr. me ngjyra; 24 cm

Parathënie: f. 6. – Referencat: f. 36

ISBN 978-9951-545-10-5

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| SHKURTESA DHE AKRONIME | 4 |
| PARATHËNIE | 5 |
| 1. Hyrje | 6 |
| 2. Integrimi gjinor në planifikimin hapësinor | 11 |
| 2.1 Rasti për integrim gjinor | 11 |
| 2.2 Si të përfshihet perspektiva gjinore në procesin e planifikimit hapësinor? | 12 |
| 2.2.1 Zhvillimi i profilit hapësinor/urban | 14 |
| 2.2.2 Vizioni, Parimet dhe Qëllimet | 18 |
| 2.2.3 Prioritetet e zhvillimit strategjik | 20 |
| 2.2.4 Korniza e zhvillimit hapësinor | 21 |
| 2.2.5 Zbatimi dhe monitorimi | 22 |
| 3. Perspektiva gjinore në praktikë: raste studimore nga komunat e Kosovës | 24 |
| 4. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për integrimin gjinor në planifikimin hapësinor | 32 |
| Referencat | 36 |
| Shtojca 1: Lista kontrolluese e integritit gjinor për dokumente të projektit apo të politikave | 37 |
| Shtojca 2: Shembull i formularit të vlerësimit gjinor | 38 |
| Shtojca 3: Shembull i matricës së analizës gjinore | 39 |

SHKURTESA DHE AKRONIME

| | |
|-------------------|--|
| ABGJ | Agjencia për Barazi Gjinore |
| AKK | Asociacioni i Komunave të Kosovës |
| AMMK | Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| CBO/OBK | Community Based Organisations/Organizatat e Bazuara në Komunitet |
| CEDAW | Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women / Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| CHwB | Cultural Heritage without Borders/Trashëgimia Kulturore pa Kufij |
| CRC | Convention on the Rights of the Child/Konventa për të Drejtat e Fëmijës |
| EPK | Ekipi Planifikues Komunal |
| FES | Friedrich Ebert Stiftung/Fondacioni Friedrich Ebert |
| GP | Grupet punuese të palëve të interesuara për çështje specifike |
| IGJ | Integrimi Gjinor |
| KB | Kombet e Bashkuara |
| M&V | Monitorimi dhe Vlerësimi |
| MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| MDGs/SZhM | Millenium Development Goals/Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MuSPP | Municipal Spatial Planning Support Programme/Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal |
| OJQ | Organizata jo-qeveritare |
| PI | Palët e interesit |
| PIK | Projekti për Investime Kapitale |
| PKVBGJ | Plani kombëtar i veprimit për barazi gjinore |
| PZHK | Plani Zhvillimor Komunal |
| QeK | Qeveria e Kosovës |
| QKSGJ | Qendra Kosovare për Studime Gjinore |
| RAE | Roma, Ashkali dhe Egjiptas |
| Sida | Swedish International Development Cooperation Agency/Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar |
| SWOT | Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats/Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Kërcënimet |
| UN-Habitat | United Nations Human Settlements Programme/Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore |
| VSM | Vlerësimi Strategjik Mjedisor |
| WUF | World Urban Forum/Forumi Botëror Urban |

PARATHËNIE

Këto udhëzime janë rezultat i përvojës së Institucioneve të Kosovës të përkrahura nga UN-Habitat-i dhe Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë. Ato kanë për qëllim të ndihmojnë qeverinë qendrore dhe lokale, si dhe shoqërinë civile, duke ofruar rekomandime për integrimin e aspektit gjinor në procesin e planifikimit hapësinor, frymëzuar nga praktikat më të mira, dhe duke ofruar një bazë të aktiviteteve dhe mjeteve për shkëmbimin dhe ngritjen e kapaciteteve.

Menaxhimi dhe planifikimi hapësinor janë pjesë e një kornize më të gjerë të qeverisjes urbane dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, është e rëndësishme për të siguruar se programet, politikat dhe projektet të ndikojnë pozitivisht dhe të forcojnë barazinë gjinore si pjesë e proceseve zhvillimore. Zhvillimi i shpejtë i zonave urbane/rurale dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, kanë shpjer gradualisht në përfshirjen e perspektivës gjinore në planifikimin e zhvillimit dhe në përfshirjen e grave dhe burrave në proceset e vendimmarrjes. Qëllimi i një qasjeje të ndjeshme gjinore është për të siguruar që gratë dhe burrat të kenë role, përgjegjësi, qasje dhe mundësi të barabarta në proceset zhvillimore të planifikimit urban strategjik, si në nivel qendror dhe atë lokal, dhe do të mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ndërhyrjet në zhvillim. Kjo do të thotë që situata dhe kushte të ndryshme të grave dhe burrave konsiderohen gjithmonë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të gjitha projektet janë të projektuara në atë mënyrë që kontribuojnë në nxitjen e barazisë.

Perspektivat gjinore të përfshira në mënyrë efektive në planifikimin hapësinor komunal dhe synimet e tij përbëjnë një hap më tej për zhvillimin e qëndrueshëm të komunave shumë-etnike të Kosovës, duke kontribuar në forcimin e demokracisë dhe promovimit të një procesi transparent të planifikimit.

Qeveritë lokale kanë një rol dhe përgjegjësi të rëndësishme në angazhimin e grave dhe burrave si të barabartë në vendimmarrjen komunale. Puna për perspektivën gjinore dhe barazinë shoqërore ofron mundësi të reja për demokratizimin e qeverisjes komunale dhe uljen e varfërisë nëpërmjet ofrimit të cilësisë, shërbimeve dhe mundësive relevante dhe efektive si për gratë ashtu dhe për burrat.

Planifikimi urban gjithëpërfshirës kërkon t'i adresojë nevojat e ndryshme të të gjithë anëtarëve të një komuniteti në mënyrën më të drejtë të mundshme. Si i tillë, konceptimi i dimensioneve gjinore në shoqëri do t'i nxjerrë në pah nevojat dhe pikëpamjet e ndryshme të burrave dhe grave në lidhje me vendbanimet ku ata jetojnë. Perspektiva gjinore do të depërtoj në pabarazitë e autoritetit në një shoqëri, dhe do t'iu mundësoj atyre adresim më të mirë të çështjeve të pabarazisë dhe marginalizimit, si në aspektin e vetë planifikimit, ashtu dhe në pjesëmarrjen e komunitetit në vlerësime dhe konsultime të nevojave. Përdorimi i qasjes gjinore në planifikim, gjithashtu do të përmirësojë nivelin e angazhimit të palëve të interesuara, duke përmirësuar kështu suksesin e përgjithshëm të procesit.

Këto udhëzime, *Integrimi Gjinor në Planifikimin Hapësinor*, Një qasje hap pas hapi për komunat, kanë për qëllim që t'ju mundësojnë vendimmarrësve në nivelin lokal dhe qendror, organizatave jo-qeveritare si dhe përfaqësuesve të komuniteteve lokale që të njihen me një shumëllojshmëri të metodave më të përshtatshme për kontekstin e tyre të zhvillimit në mbështetje të proceseve të planifikimit hapësinor, duke pasur parasysh perspektivën gjinore. Në mënyrë fleksibile dhe jo normative, ai ofron udhëzime të detajuara hap-pas-hapi për identifikimin e palëve të interesit dhe vendosjen e kornizave planifikuese dhe koordinuese të pjesëmarrjes; krijimin e profileve komunale dhe skenarëve të zhvillimit; identifikimin dhe priorizimin e strategjive të zhvillimit; dhe zhvillimin e metodologjive për zbatim dhe monitorim.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) falënderojnë si dhe organizatat e qeverisjes qendrore dhe lokale në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jo-qeveritare që kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e hartimit të këtyre udhëzimeve, sidomos MuSPP-in/UN-Habitat-in, Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK), Universitetin e Prishtinës dhe Fondacionin Friedrich Ebert (FES).

1. HYRJE

“Vajzat nuk kanë status, mbrojtje dhe perspektivë në shumë familje dhe komunitete - dhe kjo është thjeshtë mënyra se si qëndrojnë gjërat. Pabarazia është aq e ngulitur sa që ajo as nuk vihet në dyshim.”¹

Fuqizimi i grave për pjesëmarrje të plotë në të gjitha aspektet e jetës publike, dhe rruga e ndërtuar për të arritur të kuptuarit e vërtetë të rigjenerimit të rolit të femrës në shoqëri, duhet të fillojë duke zgjeruar diskutimin dhe pyetjet rreth temës së barazisë gjinore.¹

Ideja e integrimit gjinor rrjedh nga njohja se dallimet dhe pabarazitë midis grave dhe burrave janë të lidhura, dhe kanë ndikim në të gjitha aspektet e shoqërisë. Prandaj perspektiva gjinore duhet të integrohet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha shtresat e planifikimit hapësinor dhe urban dhe të menaxhimit. Nuk ka një qasje të vetme në arritjen e integrimit gjinor. Në vend të kësaj, kjo është një qasje konceptuale, e cila do të hartohet dhe të zbatohet sipas marrëveshjeve të veçanta institucionale dhe në kontekste specifike sociale dhe kulturore. Integrimi gjinor nënkupton që perspektiva gjinore do të integrohet në çdo veprimtari të ndërmarrë dhe do të informojë proceset e vendim-marrjes në nivelin e politikave dhe atë funksional. Është gjithashtu e rëndësishme të sqarohet se integrimi gjinor nuk është një qëllim në vetvete; është një mënyrë për të punuar drejt qëllimit të barazisë gjinore.

Në raportin e fundit të UN Habitat-it *Situata e Grave në Qytete* është deklaruar se “për të qenë me të vërtetë të begatë, qytetet kanë nevojë për qasje të barabartë në nevojat për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe të mirëqenies të tilla si shërbimet, infrastruktura, mjetet e jetesës, strehimin dhe kujdesin shëndetësor, krahas mjeteve të duhura për angazhimin qytetar dhe qeverisjen e shumë palëve të interesuara. Kjo qasje në

asete, burime dhe të drejta duhet të ndahet në mesin e banorëve urban nga të gjitha mjediset shoqërore në mënyra të barabarta (...). Nëse arrihen këto elemente të ndryshme, atëherë qytetet do të bëhen motor të rritjes.”²

Për fat të keq, barazia gjinore ende mbetet një sfidë, sidomos gjatë trajtimit të agjendave të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global dhe lokal. Ky publikim nxjerr në pah praktikatat e shumta të mira dhe mund të ofroj një burim frymëzimi dhe përsëritjeje. Një numër i strategjive të suksesshme janë integruar në programe nga komunat e Kosovës, sidomos përmes Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), të zbatuara nga UN-Habitat-i prej 2005-2014, dhe financuar nga Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim. Këto praktika do të paraqiten në këto udhëzime si përvoja për t'i ndarë në mes të gjitha komunave të Kosovës. Qëllimi është për të ilustruar se si këto iniciativa mund të adresojnë nevojat e të gjithë qytetarëve në nivel lokal dhe të shpiejnë drejt një ndikimi të përgjithshëm pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm.

SFONDI

Rëndësia dhe lidhja në mes të barazisë gjinore dhe planifikimit urban janë shprehur në *Agjendën e Habitatit* dhe Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (SZhM). Nevoja për barazinë gjinore ka qenë e njohur ndërkombëtarisht për shumë vite. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim të miratuara unanimisht nga 189 vende në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë të mbajtur në Pekin në

¹ Graça Machel, UN-Habitat (2012), A compendium of case studies on gender mainstreaming initiatives, f.3.

² UN-Habitat (2013), State of women in cities 2012-2013: gender and the prosperity of cities, f.5.

vitin 1995, konfirmoi plotësisht zotimin e qeverisë për të lehtësuar pabarazinë gjinore përmes integritit gjinor dhe metodave të tjera. Deklarata e Pekinit konsiderohet si dokumenti kyç i politikës globale për barazinë gjinore, duke adresuar fusha kritike si gratë dhe varfëria, dhuna ndaj grave dhe të drejtat njerëzore të grave, duke përfshirë të drejtat e grave për tokën dhe pronën. Duke u bazuar në Platformën për Veprim të Pekinit dhe politikat e instrumentet e tjera të të drejtave të njeriut³, *Agjenda e Habitatit* e miratuar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (Habitat II) në Stamboll në vitin 1996, shënoi pikën kthyesë më të rëndësishme në dhënien e rëndësisë së çështjeve të grave në lidhje me tokën dhe vendbanimet njerëzore në kontekstin e zhvillimit. Në *Agjendën e Habitatit*, KB-ja dhe shtetet anëtare të saj janë zotuar për Integrimin Gjinor si një proces kyç për të vlerësuar aftësinë e politikave dhe legjislacionit për të përmbushur nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në lidhje me vendbanimet njerëzore. Në mënyrë të veçantë, vlen të përmendet zotimi i shteteve anëtare të KB-së në paragrafin 46:

“Ne zotohemi për qëllimin e barazisë gjinore në zhvillimin e vendbanimeve njerëzore. Ne më tej zotohemi për:

(a) Integrimin e perspektivës gjinore në legjislacionin, politikat, programet dhe projektet që kanë të bëjnë me vendbanimet njerëzore përmes aplikimit të analizës së ndjeshmërisë gjinore;

(b) Zhvillimin e metodologjive konceptuale dhe praktike për përfshirjen e perspektivës gjinore në planifikimin e vendbanimeve njerëzore, zhvillim dhe vlerësim, duke përfshirë zhvillimin e treguesve;

(c) Grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave të zbërthyer gjinore dhe informacioneve mbi çështjet e vendbanimeve njerëzore, duke përfshirë mjetet statistikore që njohin dhe nxjerrin në dritë punën e papaguar të grave, për përdorim dhe zbatim gjatë planifikimit të politikave dhe programeve;

(d) Integrimin e perspektivës gjinore në hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të sigurta mjedisore dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve, teknikat e prodhimit dhe zhvillimin e infrastrukturës në zonat rurale dhe urbane;

(e) Formulimin dhe forcimin e politikave dhe praktikave për të nxitur pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të grave në planifikimin e vendbanimeve njerëzore dhe në vendim-marrje.”

3 Të tilla si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979), Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989), Deklarata e Vjenës (1993), ndër të tjera.

Në mënyrë të ngjashme, në Deklaratën e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara (2000), qeveritë janë zotuar “*në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave, si mënyrë efektive për luftimin e varfërisë, urisë dhe sëmundjeve dhe për të nxitur zhvillimin i cili është me të vërtetë i qëndrueshëm*”. Komuniteti ndërkombëtar miratoi tetë Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit, si një kornizë të mëtejshme për aktivitetet e zhvillimit të më shumë se 190 vendeve në dhjetë rajone. Këto janë artikuluar në më shumë se 20 synime dhe 60 tregues. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit janë miratuar edhe nga Parlamenti i Kosovës, prandaj Kosova duhet të raportojë mbi progresin e bërë në këto tetë fusha tematike. Barazia gjinore është bërë një faktor ndërlidhës në secilin nga qëllimet dhe në një qëllim të veçantë: Synimi 3 për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Çështjet pronësore ende mbeten një pengesë për angazhimin qytetar dhe të drejtat e barabarta për të dyja gjinitë. Tradita dhe mentalitetet paraqesin pengesa në zbatimin e të drejtave ligjore:

“Edhe nëse ligji garanton të drejtën e trashëgimisë, unë përsëri do të vendosja t’ia jap pronën time djemve të familjes (...).”

Hulumtimi dhe publikimi nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), tregon se “(...) të anketuarit ishin të gatshëm që prona të trashëgohet nga të dy gjinitë (75%), ndërsa 17% e të anketuarve mendojnë se në qoftë se të drejtat e trashëgimisë përcaktohen me ligj, përsëri prona duhet t’i lihet burrave”.

Të drejtat e grave në trashëgiminë e pronës në Kosovë, QKSGJ, Mars 2011

*Analiza Gjinore e Shtetit të Kosovës për vitin 2012*⁴ bën një vlerësim të mangësive dhe pabarazive kryesore gjinore, duke theksuar vështirësitë në qasjen gjatë zbërthimit të të dhënave dhe pabarazitë gjinore të vazhdueshme të tilla si gratë të cilat përballen me nivele më të larta të papunësisë se burrat, shfuqizimin ekonomik, dhunën në familje, dhe çështjet e shëndetit. Raporti gjithashtu vlerëson vështirësitë e veçanta të paraqitura për gratë me aftësi të kufizuara dhe për gratë që vijnë nga grupe të ndryshme etnike. Gratë e komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptas (RAE) në Kosovë janë më të pafavorizuara sesa gratë nga grupet e tjera etnike, pohon raporti, duke përmendur çështje specifike gjinore të tilla si martesat në një moshë shumë të re, përjashtimi nga shkolla, dhe ndonjëherë jetesa në kushte të tilla që paraqesin rreziqe të veçanta shëndetësore. Situata e grave me aftësi të kufizuara është ndër më të pasigurtat në Kosovë,

4 Cozzarelli, C. (2012), Kosovo Gender Assessment, Pristina: USAID/Kosovo

dhe përfshinë pengesa në qasje në shëndetësi dhe kujdes gjinekologjik, nivelet e ulëta të arsimit, izolim social, pamundësia për të pasur një punë, mungesa e fuqizimit ekonomik dhe nivelet e ulëta të fuqisë vendim-marrëse në shtëpi dhe në komunitetet e tyre⁵. Nga ana tjetër, raporti thekson pozitën shumë të mirë të vendit në lidhje me kornizën ligjore që promovon barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Së fundmi, *Profili Gjinor i Vendit, Kosovë (2014)* na jep informacion të detajuar themelor dhe ofron një burim të vlefshëm të dhënave të shpërndarjes gjinore. I kryer në periudhën janar-prill 2014, hulumtimi përfshinë intervista me informuesit kyç, fokus grupe dhe intervista në grupe me përfaqësues të ndryshëm të institucioneve qeveritare në nivel komunal dhe shtetëror, organizatat e shoqërisë civile, akterët ndërkombëtarë, akademikë, media dhe sektori privat.

“Pronësia e grave vlerësohet të jetë 8%. Edhe pse legjislacioni ofron të drejta të barabarta në trashëgiminë për fëmijët brenda dhe jashtë martesor, gjatë zgjidhjes së trashëgimisë në gjyq, gratë shpeshherë heqin dorë nga e drejta e tyre e trashëgimisë duke ia dhënë pjesën e tyre të pronës familjare vëllezërve të tyre.”

Profili Gjinor i Vendit, Kosovë, 2014, f. 11

Siç përmendet në këtë studim të fundit, Kosova ka një strukturë të mirë për sa i përket promovimit të barazisë gjinore me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2008) që përcakton kornizën e përgjithshme për integrimin e barazisë gjinore në ligje, politika, dhe shërbime publike. Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit (2011-2014) përcakton në detaje rolin e të gjithë akterëve që lidhen me parandalimin, mbrojtjen, rehabilitimin/ri-integrimin, dhe koordinimin në raste të dhunës në familje. Megjithatë, në rrugën nga politika deri në veprim shumë prej idealeve të lidhura me barazinë gjinore duket se e humbasin ndikimin e tyre dhe zbatimin i parimeve të integritimit gjinor është larg nga të qenit një realitet⁶. Është vënë re se, pavarësisht nga

5 Cozzarelli, C., Op. Cit., f. 16.

6 Analiza Gjinore e Vendit, Kosovë 2012 duke iu referuar legjislacionit kyç të Kosovës në lidhje me gjininë, ka pranuar se “ekziston një marrëveshje e të gjithëve se ka pengesa serioze që pengojnë këto ligje nga realizimi i ndikimit të dëshiruar, duke përfshirë ritmin e pamjaftueshëm të zbatimit, mungesën e burimeve buxhetore dhe mbështetjes nga financimet e donatorëve. Të intervistuarit nga QeK, shoqëria civile dhe organizatat e tjera donatore kanë qenë unanimitë në besimin e tyre se mungesa e zbatimit të kësaj pakoje ligjore është një nga faktorët kyç që kontribuojnë në këmbënguljen e vazhdueshme të pabarazive gjinore dhe mungesën e fuqizimit të grave në Kosovë. Gjithashtu në këtë situatë kontribuon edhe mungesa e madhe e vetëdijes në mesin e Kosovarëve për të drejtat e grave në përgjithësi dhe të legjislacionit në lidhje me barazinë gjinore në veçanti”. Shih Cozzarelli, C. (2012), Op. Cit., f. 22. Për këtë temë, shih gjithashtu Profilin Gjinor të Kosovës (2014).

legjislacioni i duhur⁷, ende vazhdojnë vështirësitë në zbatim dhe monitorim.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore (PKVBJG), dhe planet e tjera të veprimit të cilat synojnë rritjen e përfshirjes së grave në shoqëri⁸ janë hapa të rëndësishëm drejt zbatimit të barazisë gjinore. PKVBJG është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë në mes të Qeverisë së Kosovës, Entitetit për Barazinë Gjinore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Barazinë dhe Fuqizimin e Grave (UN-Women) dhe lëvizjes së grave Kosovare. Pavarësisht nga politikat dhe mjetet ekzistuese të duhura për të promovuar zhvillimin e balancuar gjinor në Kosovë, mungesa e funksionimit institucional operacional shpjegon rezultatet e dobëta sa i përket arritjes së barazisë gjinore.

PLANIFIKIMI HAPËSINOR NË SHIKIM TË PARË

Planifikimi hapësinor dhe dizajni urban janë mjete për bashkërendimin dhe integrimin e problemeve hapësinore, sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore në komuna. Planifikimi hapësinor shërben si një instrument kyç për të promovuar angazhimin pjesëmarrës, të menduarit strategjik, përcaktimin e vizionit dhe koordinimin territorial⁹.

Parimet themelore të një qasjeje të re strategjike të Planifikimit Hapësinor përfshijnë promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm si themel bazë, me qëllim për të arritur planifikimin e integruar në mënyrë pjesëmarrëse, duke përfshirë të gjithë partnerët dhe palët e interesuara, që promovojnë përshtatshmërinë me kërkesat e tregut, duke siguruar qasje në tokë dhe në zhvillimin e mjeteve të duhura të planifikimit. Planifikimi i integruar hapësinor është pro të varfërve dhe gjithëpërfshirës, duke pasur parasysh shumëllojshmërinë kulturore.

7 E cila përfshinë Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të vitit 2008, promovimin në mënyrë eksplicite të parimit të barazisë gjinore si vlerë themelore duke ndaluar të gjitha format e diskriminimit, Ligjin për Barazi Gjinore të vitit 2004, si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të vitit 2008, Ligjin e Punës të vitit 2011, Ligjin për Mbrojtje kundër Dhunës në Familje të vitit 2010 dhe Ligjin kundër diskriminimit të vitit 2004.

8 Plani i Veprimit i Kosovës për fuqizimin e grave në ekonomi, për shembull, ka për qëllim rritjen e vetëdijes, përmirësimin e qasjes dhe praninë e grave në administratën publike dhe punësimin e tyre në sektorin privat. Plani i veprimit është në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB-së 1325 (2000) për gratë, paqen dhe sigurinë. Është formuar grupi punues dhe ka për qëllim të përmirësojë pjesëmarrjen e grave në promovimin dhe ndërtimin e paqes si dhe pjesëmarrjen e tyre në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë.

9 UN-Habitat (2010c), Planning sustainable cities: UN-Habitat practices and perspectives, Nairobi: UNON, f. 3-4

PSE ÇËSHTJET GJINORE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR?

Gratë përballen me sfida të shumta në lidhje me pjesëmarrjen e tyre të plotë si qytetare, sidomos në aspektin e rritjes së shpejtë urbane: sigurinë personale; qasjen në hapësirën publike; lëvizshmërinë; strehimin; shërbimet publike dhe objektet lokale të tilla si dyqane, objektet e komunitetit për fëmijët dhe të moshuarit, etj. Që nga pengesat institucionale deri tek ato kulturore, pengesat për pjesëmarrje mund t'i parandalojnë vajzat dhe gratë të marrin pjesë në procese vendim marse në nivelin lokal, apo nga qasja në informata të cilat do të ndikojnë të drejtën e tyre të barabartë të mundësive dhe burimeve. Gratë me të ardhura të ulëta mund të përballen me pengesa të tjera, të tilla si mungesa e mbështetjes ligjore sa i përket zotërimit të pronës apo sfidat në qasje në shërbimet themelore urbane të tilla si uji dhe kanalizimi.

“Vendet me më tepër barazi gjinore kanë rritje më të madhe ekonomike. Kompanitë me gra udhëheqëse, kanë ecuri më të mirë. Marrëveshjet e paqes që përfshijnë gratë janë më të qëndrueshme. Parlamentet me më shumë gra miratojnë më tepër legjislacionin mbi çështjet kryesore sociale të tilla si shëndetësia, arsimiti, kundër diskriminimit dhe mbështetje për fëmijët. Është e qartë: barazi për gratë do të thotë përparim për të gjithë.”

Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, Ban Ki-moon
në Ditën e Gruas, 2014

Nga ana tjetër, mungesa e të dhënave të zërthyer gjinore, mbetet një sfidë e veçantë në planifikimin hapësinor, duke ndikuar në mënyrën se si strategjitë e zhvillimit, planet dhe programet i adresojnë nevojat specifike të grave dhe burrave. Kjo vlen lidhur me atë se si perceptohet hapësira fizike, duke përfshirë rrugët, parqet dhe transportin publik, si dhe në mënyrën se si gratë mund të kenë qasje në strukturat qeverisëse dhe shërbimet themelore, si dhe në jetën kulturore dhe ekonomike të qytetit.

Perspektivat gjinore sigurojnë informacion të vlefshëm në avancimin e nevojave dhe pikëpamjeve të gjithë anëtarëve të një komuniteti në mënyrën se si ata duan të qeverisen, se si ata ndër-veprojnë me mjedisin hapësinor dhe hapësirat e ndërtuara të tyre dhe përfundimisht se si ata duan që të zhvillohen vendbanimet e tyre. Përdorimi i qasjes gjinore në planifikim, do të përmirësojë nivelin e angazhimit të palëve të interesuara, duke përmirësuar kështu

suksesin e përgjithshëm të procesit të planifikimit hapësinor.

OBJEKTIVAT KRYESORE

Këto udhëzime kanë për qëllim të promovojnë një qasje të integritit gjinor në praktikën e zhvillimit urban dhe për të rritur njohuritë dhe kapacitetet e të gjithë palëve të interesuara që punojnë dhe kontribuojnë në fushën e planifikimit hapësinor, qeverisjes urbane dhe fusha të tjera të rëndësishme në planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Këto udhëzime janë zhvilluar si një mjet referimi për komunitatet e Kosovës dhe si rezultat i iniciativave të integritit gjinor të cilat janë ndërmarrë në mbështetje të Institucioneve të Kosovës, komunave partnere të MuSPP-it, sidomos gjatë adresimit të çështjes gjinore në qeverisjen lokale në përgjithësi dhe në planifikimin hapësinor në veçanti. Këto udhëzime janë zhvilluar në pajtim me parimet që zhvillimet e vendbanimeve njerëzore nuk duhet të jenë neutrale ndaj çështjeve gjinore (d.m.th. duke injoruar ngritjen sociale dhe kulturore të identiteteve gjinore) dhe që pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave është thelbësore në të gjitha fazat dhe nivelet e procesit të planifikimit hapësinor.

Temat kyçe në vijim për planifikimin hapësinor janë të ndërlidhura dhe duhet të adresohen sa i përket lidhjes së tyre në integritimin gjinor: ofrimi i shërbimeve publike, lëvizshmëria, strehimi, shërbimet bazike urbane (siç janë uji, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave të ngurta), qasja në arsimim dhe avancim i studimeve në arsimin e lartë, menaxhimi i mjedisit, të drejtat e tokës, zhvillimi ekonomik si dhe qeverisja dhe administrata urbane.

Përderisa shkëmbehen përvojat nga iniciativat që kontribuojnë në qëllimet e barazisë gjinore në Kosovë, ky botim synon të ofroj rekomandime praktike në lidhje me përfshirjen e perspektivës gjinore në proceset e planifikimit hapësinor, në mënyrë të veçantë në procesin e hartimit të Planeve Zhvillimore Komunale si dhe zbatimin dhe monitorimin e tyre.

Ky dokument ofron një hyrje të përgjithshme mbi çështjet gjinore në planifikimin hapësinor, bazuar nga përvoja e Institucioneve të Kosovës të përkrahura nga programi i MuSPP-it në Kosovë. Janë ofruar studime të rasteve nga qasjet e gjithëpërfshirjes së qytetit dhe aktiviteteve nëpër lagje. Studimet e hollësishme të rasteve nga komunitatet Ferizaj, Graçanicë, Hani i Elezit, Junik, Mamushë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe

Rahovec janë të përfshira si një ilustrim i integritit të suksesshëm gjinor në planifikimin hapësinor.

Edhe pse ndikimi i rasteve të përfshira në këtë publikim, veçanërisht ato më të fundit, është vështirë të maten, ato mund të jenë të dobishme në të kuptuarit e natyrës gjithëpërfshirëse të integritit gjinor në planifikimin hapësinor dhe të dokumentojnë përpjekjet e komunave për të kapërcyer hendekun në mes të politikës shtetërore dhe praktikës, si dhe realiteteve specifike të veçanta në nivel komunal.

PËR KË JANË PËRGATITUR KËTO UDHËZIME?

Të kuptuarit e nevojave të ndryshme dhe të ndërveprimit të grave dhe burrave ofron një themel të vlefshëm për vendimmarrësit, planerët, dizajnerët urban dhe palët e tjera të interesuara në procesin e planifikimit hapësinor, për të analizuar dhe përfshirë perspektivën gjinore në hartimin e kornizave të zhvillimit të përshtatura si duhet në kontekstin e veçantë.

Këto udhëzime kanë për qëllim të ndihmojnë qeveritë lokale, si dhe shoqërinë civile, duke ofruar një udhëzues hap pas hapi dhe rekomandime të përgjithshme, metoda dhe mjete se si të integrohen çështjet gjinore në planifikimin hapësinor. Udhëzimet gjithashtu sigurojnë informacion të përgjithshëm për gjininë dhe çështjet e grave dhe burrave, dhe praktika inspiruese, për trajnime dhe programe e mjete në ngritjen e kapaciteteve, formulimin e politikave dhe hartimin e programeve.

2. INTEGRIMI GJINOR NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

2.1 Rasti për integrimin gjinor

Integrimi gjinor është “formë e re e praktikave politike dhe të politikave të bazuara në gjini, si dhe është një strategji e re për zhvillimin e teorisë, e bazuar në gjini¹⁰”. Integrimi gjinor ka për qëllim adresimin e pabarazisë gjinore duke parë se si rolet e grave dhe burrave mund të artikulohen më mirë në shoqëri, si dhe duke adresuar nevojat e tyre në intervenime për zhvillim. Kjo mund të përfshijë ndryshime në politikat, marrëveshjet institucionale, ndarjen e burimeve dhe hartimin e programeve dhe projekteve. Më e rëndësishmja, në mënyrë që integrimi gjinor të jetë i rëndësishëm dhe efektiv, është që të sigurohet pronësia e komunitetit në strategjitë e integritit gjinor. Përfaqësuesit e ndryshëm qeveritar dhe joqeveritar në të gjitha nivelet duhet të jenë të përkushtuar dhe të mbështesin zbatimin e integritit gjinor.

“Nëse koncepti ‘gjinia’ duket të jetë i vështirë, atëherë mund të përdoret ‘gratë dhe burrat’ për të sqaruar se koncepti i referohet grave dhe burrave dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre. Nëse ‘Integrimi’ duket i vështirë për t’u kuptuar, atëherë mund të flitet për integritin apo përfshirjen e perspektivave gjinore, në qoftë se kjo është më e kuptueshme. Ajo që është e rëndësishme është që të gjeni kohë të kuptoni çfarë shkakton vështirësi në të kuptuarit dhe të zhvillonit mënyra të tjera për të shpjeguar konceptin. Fleksibiliteti dhe pragmatizmi janë të rëndësishme. Përvoja ka treguar se specialistët e zhvillimit e kanë kapacitetin për t’u marrë me koncepte të reja dhe komplekse. Në fakt, ata shpesh dëshirojnë të sfidohen në këtë mënyrë. Për fat të keq, promovimi i barazisë gjinore nuk i ngazëllen dhe inspiron profesionistët zhvillimor në nivelin e dëshiruar¹¹.”

10 Walby, S. (2005), Gender Mainstreaming: Productive Tensions in Theory and Practice. Social Politics: International Studies in Gender, State and Society, Volume 12, Number 3, fq. 321.

11 Hannan, C. (2003), Gender mainstreaming: Reflections on implementation of the strategy, të prezantuar në seminarin Integrimi i barazisë gjinore në bashkëpunimin zhvillimor, organizuar nga Komisioni Evropian dhe SIDA.

Integrimi gjinor është proces i vlerësimit të implikimeve për gratë dhe burrat në çdo veprim të planifikuar, duke përfshirë politikat, legjislativonin, programet dhe aktivitetet në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet.

Qëllimi përfundimtar i integritit gjinor është arritja e barazisë gjinore.

Si një strategji zhvillimore, integrimi gjinor trajton shqetësimet dhe perspektivat e të dy gjinive të integruara në kuadër të dizajnit urban, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat e zhvillimit, duke pasur si qëllim përfundimtar arritjen e barazisë gjinore, dhe në mënyrë që gratë dhe burrat të mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga proceset zhvillimore.

Gjinia ka kuptim më të gjerë se sa vetëm koncepti i gjinisë biologjike; ajo përfshinë perceptimet sociale, pritjet dhe mundësitë që lidhen me të qenit femër apo mashkull. Dimensionin kulturor i gjinisë do të ketë ndikim në rolet, përgjegjësitë, mundësitë dhe autoritetin e lidhur me secilën gjini. Perceptimet gjinore janë të bazuara në *karakterin (ethos)* kulturor dhe social. Si të tilla, këto perceptime do të variojnë, ndryshojnë dhe përshtaten në kultura të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, duke ndjekur strukturat dhe dinamikat sociale. Është e rëndësishme të theksohet se gjinia nuk i referohet vetëm grave. Ky është një keqkuptim i zakonshëm që duhet të shmanget për të përfshirë plotësisht perspektivën gjinore në planifikimin hapësinor. Integrimi gjinor nuk mund të arrihet duke u përqendruar vetëm tek gratë. Me qëllim të adresimit të roleve, përgjegjësi, qasjes në mundësitë e burrave dhe grave, djemve dhe vajzave është jetike që të përfshihet tërë komuniteti, dhe të shikohen përvojat e të dy gjinive dhe se si

ato janë artikuluar dhe bashkëjetojnë në shoqëri në përmbushjen e roleve të tyre sociale.

TRANSFORMIMI ME ANË TË INTEGRIMIT

Gratë dhe burrat dhe djemtë dhe vajzat përballen me nevoja të ndryshme në lidhje me punësimin, jetesën, tokën dhe banimin dhe mund të kenë perceptime të përgjithshme, aspirata dhe prioritete të ndryshme në jetën e përditshme. Politikat e planifikimit do të ndikojnë në komunitetet e synuara dhe aktivitetet e tyre përkatëse; Prandaj, jeta e grave dhe burrave, nevojat e tyre përkatëse dhe perspektivat e ndryshme janë një bazë e fortë në procesin e planifikimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Pabarazitë midis burrave dhe grave janë ende të dukshme dhe janë të pranishme në të gjithë sektorët e jetës politike, ekonomike dhe sociale: në tregun e punës, banim, kushte të jetesës dhe shëndetësi, qasjes në objekte, transport, pushtet dhe vendim-marrje, etj. Planifikimi mund të japë një kontribut të rëndësishëm për barazinë gjinore duke ndikuar në ndërlikohen e aktiviteteve, kushteve të veçanta dhe cilësinë e vendeve në lidhje me nevojat specifike të secilit grup të ndryshëm.

Një mënyrë themelore që pasqyron çështjet e grave në agjendat e zhvillimit dhe planifikimit është sigurimi i një pjesëmarrjeje më të madhe të tyre në qeverisjen lokale, përkatësisht në fushat politike dhe të planifikimit. Megjithatë, është vënë re se vetëm prania/paraqitja nuk është e mjaftueshme për të siguruar që pikëpamjet dhe shqetësimet e pjesëmarrësve janë respektuar plotësisht dhe janë pasqyruar më tej në procesin e planifikimit. Kjo thekson edhe më tej se roli i pjesëmarrësve në këtë proces nuk është kuptuar apo respektuar ose prania e tyre nuk është pranuar plotësisht nga përfaqësues të tjerë. Reforma ligjore dhe politike, avokimi, ngritja e kapaciteteve, dhe ngritja e vetëdijes luajnë një rol të rëndësishëm në integrimin gjinor.

Analiza e ndjeshmërisë gjinore mund të ketë ndikim në kontrollin që gratë kanë mbi mjedisin e tyre. Rezultatet e një analize fillestare të ndërmarrë në Montreal, Kanada, tregojnë se edhe pse gratë kanë qenë përdorueset kryesore të sistemit të transportit publik (që përbën rreth 60% të totalit të përdoruesve), burrat ishin më të kënaqur me shërbimin. Në fakt, shumica e grave në Montreal nuk ndjeheshin të sigurta që të ecin natën në zonën e tyre lokale. Pas kërkesës së Koalicionit të

Qendrave të Grave¹², Comité d'action femmes et sécurité urbaine (Komiteti i Veprimit për Sigurinë Urbane të Grave) iu drejtua Société de transport de la Communauté Urbaine de Montreal, i cili menaxhon sistemin e transportit publik, për të vënë në shërbim një autobus i cili do t'i mundësojë grave që të zbrisin nga autobusi në mes të dy ndalesave të rregullta gjatë natës në mënyrë që të zvogëlohet distanca e ecjes në këmbë e grave, nga autobusi për në destinacionin e tyre. Në vitin 1994, kishte filluar pilot projekti «Në mes dy ndalesave të autobusit» për të shqyrtuar dhe vlerësuar qëndrueshmërinë e shërbimit - një shërbimin vetëm për vajzat dhe gratë përdoruese. Projekti ishte bërë i përhershëm në dhjetor të vitit 1996¹³. Shërbimi "Në mes dy ndalesave të autobusit" ilustron se si proceset e integritit gjinor mund të shprijnë në një ndryshim pozitiv në drejtim të barazisë gjinore, përmirësimin e lëvizshmërisë së përgjithshme në qytet dhe në rritjen e nivelit të fuqizimit të grave.

2.2. Si të përfshihet perspektiva gjinore në procesin e planifikimit hapësinor?

Mënyra se si gratë dhe burrat përjetojnë qytetin mund të jetë krejtësisht e ndryshme. Karakteristikat hapësinore dhe organizative të veçanta të qytetit mund po ashtu të kenë një ndikim pozitiv apo negativ në këtë përvojë. Një qasje në planifikimin hapësinor që merr parasysh çështjet gjinore ka për qëllim të siguroj se të gjithë qytetarët, gratë dhe burrat, kanë mundësi të barabarta dhe mund të gëzojnë plotësisht shërbimet e ofruara nga autoritetet. i. Kjo qasje gjithashtu kërkon të mundësoj që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë gjatë dizajnit urban, ofrimit dhe menaxhimit të shërbimeve publike¹⁴.

Një qasje e ndjeshme gjinore në procesin e planifikimit hapësinor duhet të adresojë pyetjet në vijim:

- Cilat janë prioritetet, nevojat dhe rolet e ndryshme të grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, të cilat duhet të adresohen nga planet apo politikat?
- Si do të përfitojnë gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat, nga planet apo politikat?
- Si do të zbatohen, monitorohen dhe menaxhohen planet apo politikat?

12 Qendrat e grave në Montreal është një koalicion i 22 qendrave të grave, pjesëmarrja e të cilave arrin në më shumë se 40.000 gra nga Montreali

13 UN-Habitat (2008), Gender mainstreaming in local authorities: Best practices, Nairobi: UN-Habitat.

14 Idem, f. 2-3

Angazhimi me një qasje të ndjeshme gjinore në planifikimin hapësinor fillon duke adresuar pyetjet e veçanta, të cilat mund të përfshijnë:

- Cilët janë planifikuesit?
- Kush është konsultuar dhe kush merr pjesë?
- Kush e formon ekipin e politikës bërësve?
- Cilat grupe të njerëzve perceptohen si pranues të planifikimit?
- Si mbledhen statistikat dhe kë e përfshijnë ato?
- Cilat janë vlerat kyçe, prioritetet dhe objektivat e planit?
- Si vlerësohen propozimet e planifikimit? Nga kush?
- A është aspekti gjinor i integruar plotësisht në të gjitha fushat e politikës?

Royal Town Planning Institute (2003), *Gender Mainstreaming Toolkit*

Gjatë procesit të planifikimit, zbatimi i integrit gjinor zakonisht përfshinë teknika të veçanta të tilla si të dhëna gjinore; analiza të zberthyer gjinore; tregues për ndjeshmërinë gjinore; mekanizma institucional; burime të alokuara që i përgjigjen nevojave gjinore¹⁵; dhe partneriteti dhe rrjeti gjinor. Këto teknika duhet të zbatohet në të gjitha fazat e planifikimit.

Pesë hapat e mëposhtëm duhet të merren parasysh, të rregulluar sipas fazave të planifikimit hapësinor (shih figurën 1):

1. Hartimi i Profilit Hapësinor;
2. Vizioni, parimet dhe qëllimet;
3. Identifikimi i prioriteteve strategjike zhvillimore;
4. Korniza e zhvillimit hapësinor - hartimi i hartës zonale;
5. Zbatimi dhe monitorimi.

¹⁵ Todes, A.; Malaza N. and Williamson, A. (2009), Good Practice in Planning with Gender in the Commonwealth. Paper for the Women in Planning (WiP) Network of the Commonwealth Association of Planners, March 2009

1 | Fazat e Planifikimit: shembull nga një proces i planifikimit hapësinor.



Burimi: Adaptuar prej UN-Habitat-i (2007b), vëll. 1, f. 10.

PËRDORIMI I ANALIZËS GJINORE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Një nga mënyrat më të dobishme për të përfshirë perspektivën gjinore në ciklin e planifikimit hapësinor është përdorimi i teknikave të analizës gjinore në faza të ndryshme të ciklit të planifikimit (p.sh. gjatë kryerjes së analizës së palëve të interesuara, vlerësimeve të situatës urbane ose planeve të veprimit). Analiza gjinore është një metodë e shqyrtimit të shoqërisë nga pikëpamja e roleve dhe përgjegjësisë të ndryshme të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave. Duke përdorur këtë metodë, planerët mund të marrin ide më të mira nga palët e interesuara në komunitet dhe se si ato ndër-veprojnë në mjedisin urban¹⁶.

“Analiza gjinore siguron një mjet për të kuptuar marrëdhëniet që lidhen me shkakun i cili shpie drejt pabarazive gjinore në një shoqëri. Kjo është e një rëndësie të veçantë pasi që lejon që aktivitetet t'i adresojnë shkaqet më rrënjësore se sa vetëm aspektet sipërfaqësore të pabarazisë, dhe në këtë mënyrë promovon një ndikim më të madh dhe më të qëndrueshëm.”¹⁷

Si pjesë e analizës gjinore, mund të bëhen pyetje të caktuara, të tilla si (shih Shtojcën 3):

- Kush çfarë **kontrollon** në shoqëri?
- Kush **ka qasje** dhe në çka në shoqëri?
- Kush për çfarë është **përgjegjës** në shoqëri?
- Kush çka **fiton** në shoqëri?
- Kush çfarë **bën** në shoqëri?
- Kush **trashëgon çfarë**, në shoqëri?

Kjo qasje duhet të promovojë një pikë të qartë të roleve, përgjegjësisë, qasjeve dhe mundësive të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, dhe do të bashkëpunojë për të krijuar një pasqyrë të pabarazive gjinore si dhe prioriteteve në situatën lokale në studim.

Treguesit e ndjeshmërisë gjinore janë mjete themelore të analizës gjinore të çdo situatë urbane, dhe të dhënat që mblidhen gjatë gjithë procesit të planifikimit duhet të zberthehen. Megjithatë, këto aktivitete do të japin vetëm një këndvështrim të pjesshëm të dinamikës gjinore në një komunë.

Për shembull, mund të përfshihen disa tregues për të përcaktuar ndikimet gjinore në infrastrukturë/shërbime:

- Niveli i përdorimit nga ana e grave dhe burrave
- Kënaqshmëria me shërbime nga ana e grave dhe burrave
- Modelet e përdorimit nga ana e grave dhe burrave
- Koha e kursyer si rezultat i prezantimit të shërbimeve - për burrat dhe gratë veç e veç

2.2.1 Zhvillimi i profilit hapësinor/urban

Faza e parë e procesit të planifikimit hapësinor konsiston në prezantimin dhe vlerësimin e gjendjes aktuale të territorit të adresuar. Aktivitetet kryesore gjatë kësaj faze janë grumbullimi i të dhënave, identifikimi i potencialeve për zhvillim dhe identifikimi i sfidave dhe nevojave kryesore. Për të përfshirë analizën gjinore në përgatitjen e profilit është e rëndësishme që çështjet kyçe të identifikuar të adresojnë aspektin gjinor duke përfshirë identifikimin e çdo zbraçetire dhe mundësie ekzistuese lidhur me çështjet gjinore.

Objektivat për integrimin gjinor në këtë fazë

- Zhvillimi i një procesi gjithëpërfshirës për të gjitha gratë dhe burrat, djemtë dhe vajzat
- Krijimi i një baze të të dhënave e cila reflekton situatën në baza gjinore
- Zhvillimi i një analize të bazuar gjinore

REKOMANDIME

Gjatë procesit të planifikimit hapësinor dhe duke filluar nga fazat më të hershme të tij është me rëndësi jetike ngritja e vetëdijes në lidhje me rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në zonat urbane dhe rurale, duke synuar gjithashtu rritjen e pjesëmarrjes së grave. Fokusi i çdo aktiviteti për ngritjen e vetëdijesimit nuk do të jetë vetëm në dallimet në mes të roleve shoqërore të burrave dhe grave, por edhe në pabarazitë që lindin nga këto ndryshime (p.sh.: paga, skema e pensioneve, qasja në arsim, pronë, etj). Çelësi i këtij procesi është që të ngrisë vetëdijen dhe kapacitetet në mesin e komunitetit profesional (planerëve, arkitektëve dhe vendim-marrësve) në lidhje me rëndësinë e integritimit gjinor.

¹⁶ UN-Habitat (2007b), Inclusive and sustainable urban planning: a guide for municipalities, vol. 2, Nairobi: UN Habitat, f. 9.

¹⁷ UN-Habitat (2003), Toolkit for Mainstreaming Gender in UN-Habitat Field programmes, Pristina: UN-Habitat Kosovo, f. 12.



Procesi i hartimit të PZHK-së së Malishevës- Punëtorja për zhvillimin e skenarëve
© UN-Habitat, Zyra në Kosovë

Kush përfshihet në profilin hapësinor?

- Të gjitha palët e interesuara duhet të përfshihen në procesin e planifikimit prej fazave fillestare: politikanët, grupet teknike dhe të ekspertëve si dhe komuniteti lokal, me konsideratë për të dy gjinitë - burrat dhe gratë e moshave të ndryshme, grupeve sociale, etnike dhe arsimore.
- OJQ-të dhe aktivistët që punojnë në këtë fushë, sektori privat dhe komuniteti i biznesit, duke përfshirë OJQ-të që synojnë gjithëpërfshirjen dhe çështjet gjinore
- Planerët hapësinor/urban komunal
- Përfaqësues nga fusha dhe departamente të ndryshme të komunës ose ministrisë, varësisht nga shkalla e planifikimit
- Zyrtarët që merren me çështjet gjinore, në kuadër të shkallëve të ndryshme të përgjegjësi qeveritare.

Kush e fillon profilin hapësinor?

Rekomandohet që Autoriteti i Planifikimit Hapësinor të emëroj një Grup Drejtues dhe një Grup Punues. Në rastin e planeve komunale, Grupi Drejtues do të kryesohet nga Kryetari i Komunës, dhe Grupi Punues do të formohet nga përfaqësuesit e Drejtorive të Urbanizmit, Gjeodezisë, Kadastrës, Mjedisit, Administratës dhe Shërbimeve Publike. Një grup kryesor do të jetë përgjegjës për raportim. Grupi kryesor zakonisht përbëhet nga planerët kryesor.

Hap i parë i rëndësishëm në analizën e palëve të interesuara është identifikimi i të gjithë pjesëmarrësve relevantë në këtë proces, në çfarë nivele dhe faza duhet të marrin pjesë, çfarë lloji të burimeve dhe kontributit mund të ofrojnë ata në këtë proces.

“Në aspektin gjinor, kjo do të thotë se çdo analizë e palëve të interesuara duhet të bazohet në vlerësimin e roleve, përgjegjësi, qasjeve dhe mundësi të ndryshme të burrave dhe grave në komunitet. Shqyrtimi se si burrat dhe gratë janë në gjendje që të bashkëveprojnë për mjedisin e tyre urban si rezultat i gjinisë do të ofroj prova të rëndësishme në lidhje me se cilat strategji mund të përdoren përmes procesit të planifikimit strategjik urban për të përmbushur nevojat e tyre përkatëse në mënyrë të barabartë. Përveç kësaj, një konceptim i tillë do të ndihmojë për të siguruar që aktivitetet e planifikimit urban do të kontribuojnë për të promovuar barazinë gjinore mes grave dhe burrave, dhe nuk do të ketë efekt të kundërt.”¹⁸

¹⁸ UN-Habitat (2007b), *Inclusive and sustainable urban planning: a guide for municipalities*, vols. 1-5, Nairobi: UNHabitat, f. 18.

2 | Matrica e palëve të interesit në bazë të ndikimit-interesit.

| | Ndikim i ulët | Ndikim i lartë |
|------------------|--|--|
| Interesi i vogël | <i>Palë e interesuar me potencial të kufizuar për përfshirje</i> | <i>Palë e interesuar me fuqi vendim-marrëse</i> |
| Interesi i madh | <i>Palë e interesuar e rëndësishme e cila mund të ketë nevojë për inkurajim dhe mbështetje</i> | <i>Palë e interesuar me ndikim maksimal në zgjidhjen e çështjeve</i> |

Burimi: UN-Habitat (2007b), vëll.2, f. 17

Në këtë fazë, duhet të krijohet një metodologji/sistem për të mbledhur informata me fakte dhe shifra rreth burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, duke marrë në konsideratë edhe grupet e tjera të pafavorizuara. Sondazhet në terren si dhe të gjitha të dhënat të mbledhura demografike, të punës/punësimit, arsimit dhe sektorëve të tjerë të veçantë të aktivitetit duhet të ndahen/zbërthehen në baza gjinore.

Duke marr parasysh nevojat e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave, profili hapësinor/urban do të synojë identifikimin e sfidave dhe mangësive gjinore, si dhe potencialin ekzistues për zhvillim. Rekomandohet zhvillimi i një metodologjie për vlerësimin e gjendjes ekzistuese (p.sh. analiza SWOT), duke identifikuar sfidat më kryesore dhe marrjen në konsideratë të perspektivës gjinore. Reflektim i veçantë duhet të bëhet në lidhje me aspektet e mëposhtme:


- Cilat janë nevojat specifike të grave dhe burrave në lidhje me mjedisin e tyre?
- Si mund të ndikojnë vendimet e planifikimit të gratë dhe burrat?
- Cilat janë fushat e veçanta të interesit të grave dhe burrave (p.sh. strehimi, arsimit, etj)?
- Cilat janë kapacitetet e veçanta të grave dhe burrave?
- Cilat burime janë të kontrolluara nga gratë dhe cilat nga burrat?

Informatat që rrjedhin nga përfaqësuesit e komunitetit lokal, sektorit privat, qytetarëve, dhe përfaqësuesit e institucioneve jo-qeveritare, si dhe ata

të pushtetit lokal duhet të mirren parasysh. Të dhënat e mbledhura, kur analizohen nga një perspektivë gjinore, do të ofrojnë një bazë të rëndësishme dhe të vlefshme për profilin e zhvillimit hapësinor.

ASPEKTE PËR T’U KONSIDERUAR GJATË KËSAJ FAZE

- Të dhënat e mbledhura duhet të jenë të zbërthyera në aspektin gjinor
- Të anketuarit gjatë anketave në terren duhet të përzgjidhen duke marr parasysh aspektin gjinor
- Pyetësorët duhet të marrin parasysh aspektin gjinor dhe të jenë të ndjeshëm ndaj gjinisë
- Analizat gjinore duhet të nxiten që të bëhen/përgatiten më shumë dhe mund të përfshijnë sektorë të veçantë të tillë si shërbimet publike (arsimin, shëndetësinë, përkujdesjen sociale ...), transportin publik, sigurinë, qasjen në hapësirat publike, etj.
- Të merret në konsideratë se si migracioni ndikon te barazia gjinore (migrimi vetëm i burrave nga fshati në qytet)
- Pjesëmarrja e gruas në diskutimet publike duhet të nxitet (duke marrë parasysh përshtatshmërinë e kohës dhe vendin e takimeve publike)
- Duhet të mbështetet krijimi dhe funksionimi i OJQ-ve dhe OBK-ve (CBO) lidhur me çështjet gjinore
- Kapacitetet lokale duhet të promovohen si potencial për zhvillim



PZHK-ja e Graçanicës- Procesi i planifikimit
© UN-Habitat, Zyra në Kosovë

Shembulli i aplikimit të analizës gjinore në planifikimin hapësinor

Shembulli i mëposhtëm tregon një rast të auditimit gjinor në Planin Lokal të Plymouthit, Angli. Matrica e Çështjeve Gjinore ishte përgatitur për të identifikuar çështjet gjinore të cilat do të kishin implikime në planifikim dhe ishte zhvilluar për nën-temat e ndryshme që mund të ishin relevante për grupe të shumta, duke përfshirë gratë (analiza sektoriale

për sektorin e mjedisit, për mbeturinat, mineralet, strehimin, komunitetin, edukimin, shëndetin, kohën e lirë, turizmin, punësimin, blerjet, transportin, si dhe për zbatimin dhe monitorimin). Matrica është projektuar për të renditur informacionin në lidhje me jetën e përditshme të grave në zonën e studimit dhe ishte i bazuar në literaturën e planifikimit dhe ushtrimeve konsultative të zhvilluara në nivele të ndryshme (të qytetit dhe lagjes).¹⁹

¹⁹ Todes, A.; Malaza N. and Williamson, A. (2009), f. 13-14.

3 | Matrica e analizës gjinore.

| Banimi | Çështjet përkatëse gjinore | Burimi i të dhënave | Implikimet në planifikim |
|--|--|---|--|
| Kufizimi i zgjedhjes së llojit të banimit dhe lokacionit | Shumë gra mund të jenë të detyruara të marrin me qira ose të jetojnë në njësi banimi me standarde të ulëta, apo larg nga shërbimet dhe lehtësirat e tjera për shkak të të ardhurave të ulëta | Ushtrimi i konsultimeve Statistikat e banimit Statistikat e punësimit | Inkurajimi i ofrimit të njërive të banimit me qira me kosto të ulët, të vendosura në qendrën e qytetit dhe pjesë të tjera të përshtatshme me shërbimet e ofruara |

Burimi: Todes, A.; Malaza N. dhe Williamson, A. (2009), f. 13.

Ky informacion do të jetë bazë për hartimin e objektivave të planit dhe do të ndihmojë në identifikimin e sektorëve ku mund të pritët ndikimi gjinor dhe ku një perspektivë gjinore mund të rrisë mundësitë për zhvillimin e politikave të ndryshme lokale.

2.2.2 Vizioni, Parimet dhe Qëllimet

Gjatë fazës së dytë të procesit të planifikimit hapësinor përcaktohet vizioni, parimet dhe qëllimet të cilat do të drejtojnë zhvillimin e ardhshëm të territorit të adresuar për një periudhë të caktuar kohore. Aktivitetet kryesore gjatë kësaj faze janë përcaktimi i vizionit për zhvillim²⁰, parimet kryesore të ndjekur nga qëllimet dhe objektivat.

Objektivat për integrimin gjinor gjatë kësaj faze

- Identifikimi i ekuilibruar dhe gjithëpërfshirës i vizionit të zhvillimit, parimeve dhe qëllimeve për të përmbushur nevojat e përbashkëta dhe të veçanta të grave dhe burrave.

²⁰ Në lidhje me këtë, shih UN-Habitat (2012e), *Visioning as participatory planning tool*. Ai u përgatit sipas praktikës së UNHabitat-it në Kosovë, me qëllim të "frymëzimit dhe inkurajimit të planerëve lokal, politikanëve, shoqërisë civile dhe mediave për t'u angazhuar në dizajnimin/definimin e së ardhmes së vendbanimeve njerëzore në mënyrë bashkëpunuese me përdorimin e vizionimit".

Qëllimet dhe objektivat e identifikuar gjatë kësaj faze duhet të maten jo vetëm me tregues sasiore, por edhe duke përdorur qasje cilësore që mund të përfshijnë perspektivat dhe pikëpamjet e palëve të ndryshme të përfshira në proceset e planifikimit.

REKOMANDIME

Procesi përfshinë rritjen e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare, përfaqësuesve të nivelit qendror dhe lokal nëpërmjet përfaqësimit të barabartë të burrave dhe grave, të rinjve dhe të moshuarve, sektorit privat dhe sektorit të arsimit në zhvillimin e vizionit, prioritetëve, strategjive dhe qëllimeve. Në këtë fazë, duhet të identifikohen palët e interesuara dhe duhet të nxitet pjesëmarrja e tyre, si pjesë e rëndësishme e formimit të zhvillimit të ardhshëm për territorin në fjalë. Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve për perspektivën gjinore gjithashtu mund të promovohen si pjesë e këtij procesi.

MuSPP-i ka publikuar një mjet të veçantë për zhvillimin e proceseve të vizionimit në nivel vendor (shih publikimin *Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës* e UN-Habitatit, 2012. Rekomandohet që mjeti i vizionimit të përshtatet në kontekstin specifik lokal të qasjes së planifikimit pjesëmarrës

4 | Treguesit gjinor cilësor dhe sasiore.

| Metodologjia | Përkufizimi i punës |
|--------------|---|
| Sasiore | <i>Metodat sasiore të mbledhjes së të dhënave nxjerrin rezultate sasiore, kështu që ato përqëndrohen në çështjet të cilat mund të numërohen, të tilla si përqindjet e grave dhe burrave në kuvend, normat e pagave të burrave dhe grave ose normat e përfshirjes së vajzave dhe djemve në shkollë. Të dhënat sasiore mund të tregojnë ndryshimet në barazinë gjinore me kalimin e kohës - për shembull, një tregues sasiore i përdorur mirë është numri i vajzave në shkollë në krahasim me djemtë.</i> |
| Cilësore | <i>Metodologjitë cilësore përfshijnë përvojat, mendimet, qëndrimet dhe ndjenjat e njerëzve - për shembull përvojat e grave në kufizimet apo përparësitë e punës në sektorin joformal, ose pikëpamjet e burrave dhe grave mbi shkaqet dhe pasojat e dhunës në familje. Shpesh metodologjitë pjesëmarrëse të tilla si diskutime në fokus grupe dhe mjetet e identifikimit të çështjeve sociale përdoren për të mbledhur të dhënat për treguesit cilësor. Të dhënat cilësore gjithashtu mund të mblidhen nëpërmjet anketave që matin perceptimet dhe mendimet.</i> |

duke shpjeguar përfshirjen e perspektivës gjinore në çdo fazë.

Aktivitetet e veçanta mund të përfshijnë:

- Zhvillimi i një “mjete të vizionimit” specifik, i përshtatur me karakteristikat e zonës së studimit, me treguesit gjinor (p.sh. shenjat treguese, faktet, numrat, opinionet apo perceptimet)
- Hartimi i një liste kontrolluese gjinore «(shih shtojcën 1)
- Identifikimi i kontributit të parashikuar të palëve të interesuara, femrave dhe meshkujve
- Identifikimi i qartë i ndikimit të vizionit, parimeve, qëllimeve dhe objektivave për të dy gjinitë
- Krijimi i një liste të organizatave jo-qeveritare, rrjeteve, shoqatave të biznesit dhe grupeve të tjera me ndikim në mënyrë që të lehtësojnë konsultimet me ta duke pasur parasysh përfshirjen e barabartë të burrave dhe grave në fazat e përgatitjes, si dhe në takimet, grupet punuese dhe të sigurojnë se mendimet dhe sugjerimet e tyre janë të përfshira në mënyrë të barabartë në të gjitha dokumentet e përgatitura duke marrë parasysh perspektivën gjinore
- Aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve në perspektivën gjinore në dimensionin hapësinor, duke synuar palë të ndryshme të interesit që janë pjesë e procesit (kjo mund të përfshijë programe specifike të trajnimit për zyrtarët komunal, mësimdhënësit, qytetarët, dhe shkëmbimin e përvojave)

Sigurimi se të gjitha dokumentet e hartuara gjatë kësaj faze përfshijnë treguesit e perspektivës gjinore:

- Ndikimi i vizionit për burrat dhe gratë
- Parimet - ndikimi te të dy gjinitë
- Qëllimet dhe objektivat - ndikimi te të dy gjinitë
- Konsideratë e kujdesshme për nevojat dhe prioritetet e identifikuara, të përbashkëta për të dy gjinitë dhe atyre specifike për burrat dhe gratë

Kush konsultohet dhe kush merr pjesë?

- Të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e përfshirë, duke përfshirë edhe ata nga niveli i lagjes me konsideratë të veçantë për grupet e pakicave (personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, grupet e ndryshme etnike, etj)
- Komunitat fqinje dhe/apo rajonet dhe autoritetet përkatëse të cilat mund të ndikohen nga propozimet
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ministritë e tjera relevante
- Ekspertët, akademikët, institucionet kërkimore, grupet formale dhe joformale

“Një prej kriterëve themelore të arritjes së një ‘Qyteti më Gjithëpërfshirës’ është ndërmarrja e ‘Vizionimit Gjithëpërfshirës’. ‘Vizionimi Gjithëpërfshirës’ mbështetet në dy shtylla: njëra ka të bëjë me përfshirjen e të gjitha palëve me interes dhe grupeve të cenueshme në procesin e vizionimit; ndërsa shtylla tjetër sigurohet që vizioni (dhe plani i veprimit strategjik dhe projekte e derivuara) kontribuojnë në ‘Qytet më Gjithëpërfshirës’. ‘Vizionimi me ndjeshmëri gjinore’ mund të konsiderohet si një komponentë specifike e ‘Vizionimit Gjithëpërfshirës’, me synim sigurimin e qasjes së barabartë në mundësitë e ofruara nga qyteti për të gjithë burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat në të gjitha aspektet e shoqërisë. Kjo qasje që shpesh emërtohet si ‘Integrimi Gjinor’ kërkon arritjen e qëllimeve dhe synimeve të veçanta për përfshirjen e çështjeve gjinore”.

Publikimi Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës (UN-Habitatit 2012) është rezultat i praktikës së UN-Habitatit në Kosovë, duke ndarë përvojën e MuSPP-it në zhvillimin e proceseve të vizionimit në Kosovë. Ajo përmban një përmbledhje të mjeteve të planifikimit, ushtrime dhe ide për udhëheqësit e interesuar për ta përdorur këtë metodë në punën e tyre.





Punëtorja e Vizionimit- Procesi i planifikimit në Komunën e Gjakovës
© UN-Habitat, Zyra në Kosovë

2.2.3 Prioritetet e zhvillimit strategjik

Prioritetet zhvillimore strategjike për zhvillimin e ardhshëm të territorit të adresuar identifikohen gjatë fazës së tretë të procesit të planifikimit hapësinor, i cili do të vijë si reflektim i vizionit, parimeve, qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në fazën e mëparshme. Korniza e vlerësimit do të lejojë prioritizim të balancuar të strategjive bazuar në nevojat e identifikuara, të përbashkëta për të dy gjinitë dhe atyre specifike për burrat dhe gratë.

Objektivat për integrimin gjinor gjatë kësaj faze

Prioritizimi i balancuar i strategjive të zhvillimit për të përmbushur nevojat e përbashkëta dhe të veçanta për burrat dhe gratë.

REKOMANDIME

Rekomandohet që gjatë procesit të inkurajohet pjesëmarrja e grave dhe përdorimi i analizës së palëve të interesuara në përgatitje për ndërtimin e skenarëve dhe zhvillimin e strategjive, si një kontribut për zhvillimin strategjik të propozuar. Është e rëndësishme të sigurohet se burrat dhe gratë janë të përfshirë në mënyrë të barabartë dhe nevojat dhe prioritetet e tyre janë konsideruar në mënyrë të barabartë gjatë procesit të formulimit të strategjive.

Gjatë hartimit të strategjive duhet të trajtohen çështjet gjinore. Kërkesa të veçanta për secilën gjini duhet të konsiderohen me kujdes dhe ndjeshmëria gjinore është e nevojshme atëherë kur trajtohet përdorimi

Kush është i përfshirë në hartimin e Prioriteteve të Zhvillimit Strategjik?

Në këtë fazë pjesëmarrja e udhëheqësve politikë duhet të përforcohet. Është e nevojshme një mbështetje e fuqishme nga përfaqësues të ndryshëm të fushave të ndryshme (komuniteteve qeveritare, jo-qeveritare dhe lokale). Përfshirja e përfaqësuesve që kanë të bëjnë me çështjet gjinore mund të ndihmojë në përforcimin e një strategjie gjinore.

dhe cilësia e hapësirave publike. Rekomandohet lidhje e veçantë për fusha të caktuara të tilla si: sigurimi, qasja dhe lëvizshmëria, banimi, shërbimet publike, rekreacioni dhe shërbimet publike.

Vlerësimi i Ndikimit Gjinor duhet të jetë pjesë e integruar e procesit dhe do të ofrojë mjete për shqyrtimin e ndikimit të politikave të propozuara nga perspektiva gjinore. Disa tregues që mund të merren parasysh në vlerësimin e tillë:

- **Qasja dhe Lëvizshmëria**
 - Qasja e sigurt për këmbësorët (duke përfshirë edhe njerëzit me aftësi të kufizuara) në funksionet publike;
 - Skema e transportit publik e cila mundëson qasje të lehtë dhe të sigurt për pjesët e vendbanimeve më të gjallërueshme dhe ato më të rrezikuara;
- **Banimi**
 - Ofrimi i banimit të përballueshëm financiarisht;
- **Shërbimet publike**
 - Ofrimi i kujdesit për fëmijët në lidhje me vendet e banimit dhe punës;



PIK Graçanicë, qytetarët, prindërit, mësuesit dhe nxënësit janë duke vënë idetë e para në letër për oborrin e shkollës
© UN-Habitat, Zyra në Kosovë

• Hapësirat rekreative dhe publike

- Infrastruktura e duhur teknike;
- Mobilimi adekuat urban;
- Ofrimi i funksioneve mbështetëse (p.sh. tualete publike).

Gjatë kësaj faze rekomandohet që të zhvillohet një përmbledhje mbi ndikimet dhe efektet e veprimeve dhe ndërhyrjeve të nevojshme nga perspektiva gjinore. Rekomandohet që kjo përmbledhje të ofrohet gjatë prezantimeve publike. Drafti përfundimtar i dokumentit të planifikimit hapësinor duhet të sigurojë që perspektiva gjinore është përfshirë si një kapitull mbi procesin, duke përkrahur përfshirjen e palëve të interesuara (burra dhe gra) dhe mjetet e përdorura për të mbledhur opinionet dhe inputet (p.sh. analiza e palëve të interesuara, të dhënat e zberthyer sipas gjinisë, takimet, sondazhet e opinionit, punëtorive të vizionimit, grupet e punës etj).

2.2.4. Korniza e zhvillimit hapësinor

Gjatë fazës së katërt të procesit të planifikimit hapësinor, korniza e zhvillimit hapësinor duhet të përcaktohet qartë. Aktivitetet kryesore gjatë kësaj faze përcaktojnë konceptin e zhvillimit hapësinor, përdorimin e tokës dhe hartat përkatëse. Këto aktivitete do të pasqyrojnë synimet dhe do të përcaktojnë strategjitë e zhvillimit në fazat e para.

Objektivat për integrimin gjinor gjatë kësaj faze

- Caktimi i balancuar i aktiviteteve hapësinore për të përmbushur nevojat e përbashkëta dhe të veçanta për burrat dhe gratë.

- Pjesëmarrja e gruas në procesin e planifikimit të fuqizuar dhe sigurimi që asnjë grup i veçantë të mos konsiderohet më pak i rëndësishëm në fazat më teknike të procesit të përgatitjes së planeve

REKOMANDIME

Rekomandohet shkëmbimi i përvojave dhe informatave për qasjen gjinore në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e projekteve. Gjatë procesit të hartimit të Kornizës së Zhvillimit Hapësinor, mund të përfshihen këto aktivitete specifike:

- Identifikimi i hapësirave për shfrytëzim, të krijuara në mënyrë të barabartë nga gratë dhe burrat
- Ndërhyrjet specifike gjinore
- Aktivitete/projekte që mundësojnë/rrisin direkt ose indirekt një pjesëmarrje më aktive të grave në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendbanimit
- Një formë vlerësimi për ndikimin e planifikimit të përdorimit të tokës në burra dhe gra (shih Shtojcën 2)

Kush është i përfshirë në kornizën e zhvillimit hapësinor?

- Grupi Punues me rolin relevant të planerëve hapësinor/urban komunal
- Ekipi teknik, duke marrë në konsideratë që pjesëmarrja e grave duhet të çmohet/vlerësohet



Procesi i hartimit të PZHK-së së Graçanicës
© UN-Habitat, Zyra në Kosovë

2.2.5 Zbatimi dhe monitorimi

Gjatë fazës së pestë të procesit të planifikimit hapësinor, duhet të merren masa të veçanta me qëllim për të udhëhequr dhe për të vlerësuar zbatimin e politikave / ndërhyrjeve të përcaktuara në fazat e mëparshme.

Kush është i përfshirë në zbatim dhe monitorim?

- Planerët hapësinor/urban komunal
- Ekspertët, Universitetet
- Qytetarët
- Autoritetet e planifikimit

Objektivat për integrimin gjinor gjatë kësaj faze

- Krijimi i dispozitave për pjesëmarrjen e barabartë të palëve të interesit, gra dhe burra
- Ruajtja dhe përforsimi i informacionit për qytetarët në përgjithësi dhe grave në veçanti gjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit
- Sigurimi që monitorimi të jetë i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore, duke përfshirë edhe rezultatet cilësore dhe sasiore në të gjitha nivelet e zinxhirit të rezultateve

REKOMANDIME

Si pjesë e procesit mund të propozohen aktivitete specifike rreth vetëdijesimit të publikut në lidhje me integrimin gjinor, duke synuar shoqërinë civile dhe organizatat lokale:

- Ofrimin e trajnimeve në çështjet gjinore për organizatat qeveritare (stafit në të gjitha nivelet) dhe organizatat joqeveritare
- Pilot projekti për planifikimin hapësinor me ndërhyrjet specifike gjinore
- Shpërndarja e informatave dhe materialeve të trajnimit lidhur më çështjet gjinore (mësimet e mësuara, publikimet ...)
- Zhvillimi i një strategjie të komunikimit me informacione specifike gjinore (të cilat mund të përfshijnë informata në ueb faqe, fushata mediale, buletinin informativ të komunitetit, diskutime publike në forume të ndryshme, lloje të ndryshme të fletushkave)
- Organizimi i një forumi interaktiv (nëpërmjet rrjeteve sociale, media, etj)
- Vendosja e kutisë për komente dhe pyetje në vende publike
- Përfshirja e shkollave dhe universiteteve në aktivitetet e vetëdijesimit gjinor

Për të vlerësuar ndikimin e integrimit gjinor në zhvillimin e planifikimit hapësinor dhe zbatimin e tij është e rëndësishme që të:

- Formohet një ekip vlerësues me ekspertizë të mjaftueshme gjinore dhe/ose të përfshihet një specialist i çështjeve gjinore në ekip, si p.sh. zyrtarin komunal për çështje gjinore. Udhëheqësi i ekipit duhet të ketë kapacitetin për të integruar shqetësimet e barazisë gjinore në të gjeturat, përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimit.
- Identifikohet një mostër konsultimi i cili përfaqëson mundësitë e investimeve (p.sh. gjinia, mosha, përkatësia etnike, raca dhe grupet socio-ekonomike)
- Monitorohet dhe analizohet efikasiteti i gjinisë dhe vetëdijes kulturore të bazuar në mësimet e nxjerra
- Identifikohen avantazhet dhe disavantazhet në lidhje me çështjet gjinore
- Vlerësohet ndikimi i planifikimit dhe zbatimit të tij nga perspektiva gjinore
- Sigurohet se çështjet gjinore janë të përfshira në mësimet e nxjerra dhe janë shpërndarë në mënyrë të gjerë

Shembull i zbatimit

Qëllimi i Programit për Përmirësimin e Mjedisit të Ndërtuar (BEIP)²¹ ishte për të siguruar një qasje të integruar të planifikimit për banim dhe sigurimin e infrastrukturës, veçanërisht në komunitetet e varfra dhe të marginalizuara në Thatta, Pakistan. Qyteti historik me 220.000 banorë u ballafaqua me një presion të madh për sa i përket jetesës dhe bazave të ekosistemit, për shkak të fatkeqësive natyrore. Projekti ka kombinuar iniciativa të ndryshme që kanë për qëllim rritjen e qasshmërisë në objekte të përmirësuara të infrastrukturës bazike (të tilla si trajtimin e ujërave të zeza, zhvillimin e kanaleve të kullimit të rrugëve, etj) dhe një shumëllojshmëri të përmirësimeve në banimin e përballueshëm, ndërsa në të njëjtën kohë kanë ofruar ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve në lidhje me menaxhimin e zhvillimit të projektit dhe asistencës teknike për planifikim dhe projektim më të mirë. Gjithashtu është kërkuar input në mënyrë specifike nga gratë gjatë fazave të planifikimit dhe zbatimit të BIEP. Gratë janë inkurajuar që të ndihmojnë

dhe të udhëheqin projektin duke identifikuar dhe përzgjedhur lokacionet për instalimin e përmirësimeve të mjedisit jetësor të projektit dhe ndërhyrjeve teknologjike dhe ishin të përfshira edhe në ndërtimin e këtyre përmirësimeve. Për më tepër, edukimi joformal i grave për shëndetin e brendshëm dhe higjienës është ofruar përmes seminareve, takimeve dhe informimeve në terren. Shërbimi i planifikimit dhe ndërtimit Aga Khan, Pakistan, subjekti përgjegjës për menaxhimin e këtij projekti, arriti në përfundimin se gratë kanë më tepër njohuri për problemet e banimit dhe infrastrukturës së komunitetit se sa burrat. Organizatat e Zhvillimit të 10 Fshatrave kanë lejuar procesin e pjesëmarrjes së komunitetit për të qenë përsëritës dhe për të krijuar vazhdimësi mes fazës së projektimit dhe të zbatimit.

²¹ Programi është një iniciativë e Shërbimit të Planifikimit dhe Ndërtimit Aga Khan, Pakistan, dhe ka për qëllim zhvillimin dhe promovimin e zgjidhjeve për banim dhe çështjet e lidhura me ndërtimin e mjedisit. BEIP është fitues i Çmimit të Habitatit Botëror, në vitin 2006, për përpjekjet e tij për përmirësimin e kushteve të banimit në Pakistan.


3. PERSPEKTIVA GJINORE NË PRAKTIKË: RASTE STUDIMORE NGA KOMUNAT E KOSOVËS

Qasjet gjithëpërfshirëse të planifikimit hapësinor duhet të ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm, duke balancuar zhvillimet njerëzore/sociale me zhvillimin mjedisor dhe ekonomik. Angazhimi i shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes dhe ndërtimit të konsensusit për çështjet e zhvillimit lokal duhet të jetë një nga parimet kryesore të qasjes gjithëpërfshirëse të planifikimit hapësinor.

Iniciativat në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal mund të ofrojnë mësim për të tjerët që të mësojnë nga to, dhe në veçanti ofrojnë një bazë për shkëmbim ndër-komunal. Disa nga rastet e

dokumentuara më poshtë janë gjithëpërfshirëse dhe janë të bazuara në politikat mbështetëse, ndërsa të tjerat janë pilotuar për çështje të veçanta, të tilla si uljen e rrezikut nga përmytjet, përmirësimin e hapësirave publike ose të qasjes. Ato janë rezultat i përvojës së institucioneve të Kosovës të përkrahura nga UN-Habitati dhe të njëjtat janë zhvilluar me komunitet partnerë prej vitit 2005 deri në 2014²².

5 | Integrimi gjinor si një shtyllë e planifikimit hapësinor komunal.



Burimi: MuSPP3 / UN-Habitat

²² Mbështetja u ofrua përmes MuSPP-it, Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë, i zbatuar nga UN-Habitati dhe financuar nga Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim.



©UN-Habitat Kosovo Procesi i hartimit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", përfshirë procesin e komponentës mjedisore/ VSM-së

Titulli i projektit:

Plani Zhvillimor Komunal dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Graçanicës

Komuna:

Graçanicë

Viti i zbatimit:

2011 - 2013

Partnerët kyç të zbatimit:

Komuna; MuSPP/UN-Habitat-i; Komuniteti; OJQ-të; MMPH-ja

Përfituesit e synuar: të gjithë anëtarët e komunitetit

Objektivat kryesore: Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal është që të ofrojë një vizion dhe qëllime të qarta për zhvillimin hapësinor komunal në të ardhmen dhe të përcaktoj programet, politikat dhe aktivitetet e zhvillimit për realizimin e qëllimeve të identifikuara: si të menaxhoj banimin; si të ruaj dhe zhvilloj burimet natyrore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në favor të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale; si të lehtësoj lëvizjen e banorëve dhe të ofroj qasje më të lehtë për vizitorët, etj.

Plani Zhvillimor Komunal i Graçanicës ofron një strategji për zhvillimin urban të komunës dhe më tej këshillon në çështjet themelore të planifikimit. Plani Zhvillimor Komunal do të luaj një rol kyç në tërheqjen dhe orientimin e investimeve private dhe komerciale. Për më tepër, kjo do të shërbejë si bazë për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.

Përmbledhja e projektit: Hartimi i PZHK-së ka marrë parasysh kushtet ekzistuese, problemet dhe burimet në dispozicion për zhvillim; çështjet sociale, ekonomike dhe mjedisore të komunës në tërësi. PZHK-ja integron dhe koordinon planet sektoriale dhe i radhit burimet dhe kapacitetet e komunës në zbatimin e saj, duke siguruar një kornizë të përgjithshme dhe udhëzues për zhvillimin afatgjatë në të ardhmen, dhe për koordinimin e punës së administratës lokale në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunë.

Të dy dokumentet, PZHK-ja dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) janë hartuar me mbështetjen e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP), të zbatuar nga UN-Habitat-i dhe financuar nga Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim. Procesi i hartimit të PZHK-së dhe VSM-së u zbatua paralelisht me komponentin e MuSPP/UN-Habitat-it për trajnim dhe ngritje të kapaciteteve, përmes bashkëpunimit të përditshëm dhe ndihmës në vendin e punës për stafin komunal, si dhe vizitave në terren, vizitave studimore, takimeve, punëtorive dhe veprimtarive të tjera, të cilat në fund të fundit shpijnë në një kapacitet të ngritur dhe forcimin institucional për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë që lidhen me planifikimin hapësinor.

I gjithë procesi ka rritur transparencën në proceset e vendimmarrjes nëpërmjet një sërë takimesh publike dhe konsultimesh me grupet e interesit që përfaqësojnë institucionet publike, organizatat

joqeveritare, bizneset, mediat dhe komuniteti në përgjithësi; i cili në të njëjtën kohë ka ngritur vetëdijen e palëve të interesit në fjalë në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

Procesi i VSM-së ka filluar prej fillimit të procesit të hartimit të PZHK-së dhe ka qenë plotësisht i integruar në të, kështu që ai ka përforcuar bashkëpunimin e ngushtë mes MuSPP-it, komunës, IPH-së dhe OJQ-ve lokale. Në mënyrë që të përcaktohen objektivat e VSM-së dhe diskutimi i draft objektivave, janë mbajtur punëtori me pjesëmarrjen e zyrtarëve nga fusha të ndryshme në komunë, IPH-së, MMPH-së dhe OJQ-ve, që të gjithë kanë kontribuar në hartimin e objektivave të VSM-së dhe në procesin e përgjithshëm të planifikimit hapësinor.

Procesi i pjesëmarrjes publike në Planin Zhvillimor Komunal dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor ka qenë gjithëpërfshirës dhe ka të integruar të dy gjinitë në proceset e planifikimit hapësinor dhe integrimin të mjedisit.

Rezultatet kryesore: Procesi i pjesëmarrjes ka nxitur bashkëpunimin ndërmjet pushtetit lokal dhe qendror; dhe gjithashtu ka ndihmuar në promovimin e barazisë gjinore përmes angazhimit të grave në punëtori dhe gjatë procesit të konsultimit publik. Procesi ka përfshirë gratë nga fusha të ndryshme profesionale për të dhënë kontributin e tyre gjatë punëtorive, të cilat kanë përfaqësuar komunën, IPH-në dhe MMPH-në. Projekti gjithashtu ka angazhuar të gjithë anëtarët e komuniteteve të ndryshme në punën në grup, duke ndihmuar në promovimin e pjesëmarrjes dhe proceseve të planifikimit hapësinor dhe ngritjes së vetëdijes mjedisore.

Ndikimi të komunitetet dhe / ose institucionet: Projekti ka ngritur vetëdijen në nivelin lokal dhe qendror për bashkëpunim të qeverisjes, planifikimit hapësinor dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mësimet e nxjerra: Të dy gjinitë kanë qenë të pranishme në punëtoritë e mbajtura për VSM-në dhe PZHK-në. Në punëtori u vu re se gratë kanë marrë pjesë në mënyrë më aktive dhe kanë dhënë një kontribut të madh për planin. Kontributi i tyre është marrë në konsideratë gjatë procesit të hartimit. Përbërja e Ekipit Planifikues Komunal të Graçanicës dhe Grupit Qendror të cilët kanë punuar në PZHK ishte pak më i veçantë nga të tjerat në aspektin e gjinisë; shumica e anëtarëve aktivë ishin gra,

përfshirë Drejtoreshën e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Koordinatorin për hartimin e PZHK-së. Kjo në një farë mënyre ka balancuar dominimin e përfaqësuesve meshkuj nga fshatrat dhe komuniteti. Planifikimi hapësinor, mbrojtja e mjedisit dhe vetëdijesimi, hartimi dhe zbatimi përmes qasjes pjesëmarrëse do të inkurajoj gratë që të jenë aktive edhe në veprimtari të tjera komunale.

Rekomandimet/vëzhgimet: Ndonjëherë është e nevojshme që të organizohen takime të ndara me palët e ndryshme të interesit. Në komunën e Graçanicës, pasi që qytetarët nuk kanë marrë pjesë në masë të kënaqshme në debatet publike, një takim i veçantë u organizua me përfaqësuesit e fshatrave për të adresuar problemet dhe nevojat e tyre specifike. Është shumë e rëndësishme që gjatë angazhimit të përdoren forma të ndryshme, si pyetësorë ose organizimin e takimeve gjatë fundjavës për ata që nuk mund të marrin pjesë gjatë ditëve të punës, me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes dhe të marrjes parasysh së nevojave për të gjithë.

Titulli i projektit:

Plani Zhvillimor Komunal, Ferizaj

Lokacioni/Komuna:

Ferizaj

Viti i zbatimit:

2006-2007

Burimi i buxhetit:

Komuna e Ferizajt

Partnerët kyç të zbatimit:

Komuna; MuSPP/ UN-Habitat-i; Komuniteti; OJQ-të; MMPH

Përfituesit e synuar:

Profesionistët; akademikë; shoqëria civile; publiku i përgjithshëm.

Objektivat kryesore: Hartimi, nëpërmjet përfshirjes së komunitetit, një vizion për zhvillimin e ardhshëm të zonës komunale dhe urbane të komunës së Ferizajt.

Aktivitetet specifike në integrimin gjinor:

Përfshirja e të dy gjinive prej fillimit të procesit të PZHK-së dhe PZHU-së pasuese, në vendosjen e objektivave dhe planin e veprimit në të cilin janë marrë në konsideratë nevojat e grave dhe burrave.

Është krijuar një marrëveshje specifike (pakt urban) në mes të organizatave lokale joqeveritare dhe qeveritare që operojnë në Ferizaj, këshill joformal për organizatat e shoqërisë civile, i cila kishte një rol udhëheqës në këtë proces, duke përfaqësuar të gjitha organet joqeveritare në komunë.

Rezultatet kryesore: Gratë dhe burrat kanë marr pjesë dhe kanë shprehur nevojat e veçanta të të dy palëve nëpërmjet theksimit të objektivave për zhvillim në të ardhmen.

Ndikimi te komunitetet dhe/ose institucionet: Të kuptuarit më mirë në mesin e komuniteteve, qeverisjes lokale dhe qendrore për integrimin e çështjeve gjinore në planifikim dhe buxhetim.

Mësimet e nxjerra: Kur marrin pjesë gratë dhe burrat paraqitet një kuptim më i mirë i situatës dhe kapacitetit vijues për të adresuar nevojat e grupeve të ndryshme të shoqërisë.

Rekomandimet / vëzhgimet: Këshilli joformal për organizatat e shoqërisë civile në Ferizaj u themelua në fillim të procesit dhe ishte një mbështetje e fortë për të. Institucionalizimi dhe mekanizmat pasues duhet të krijohen për të përforcuar synimet e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e shtuar të të gjithë qytetarëve.

Titulli i projektit:

Zvogëlimi i rrezikut ndaj fatkeqësive

Lokacioni/Komuna:

Ferizaj

Viti i zbatimit:

2009-2011

Partnerët kyç të zbatimit:

Komuna; MuSPP/ UN-Habitat-i; Komuniteti; OJQ-të

Përfituesit e synuar:

Komuniteti; Stafi profesional; Akademikët

Objektivat kryesore: Projekti ka pasur për qëllim vlerësimin e rrezikut dhe prekshmërisë/ cenueshmërisë, si dhe përcaktimin e strategjive dhe veprimeve për Zvogëlimin e Rrezikut ndaj Fatkeqësive.. Projekti gjithashtu ka pasur si synim ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal dhe

komunitetit për të kuptuar rëndësinë e integritit të menaxhimit të fatkeqësive në planifikim. Pas miratimit të Planit Zhvillimor Urban në vitin 2009, UN-Habitat-i së bashku me Komunën e Ferizajt ka kryer një anketim në terren dhe menjëherë ka kryer edhe një studim hidrologjik. Vendndodhja për projektin u zgjodh (lagja «Ura e Dudit») për projektimin e shtratit të lumit dhe duke pasur parasysh reduktimin e përmbytjeve dhe përmirësimin e hapësirave publike.

Aktivitetet specifike në integrimin gjinor: Takime me burra dhe gra; përfshirja e tyre prej fillimit të projektit deri në zbatimin e tij. Vetëdijesimi/ përgatitja e komunitetit.

Ndikimi te komunitetet dhe/ose institucionet:

Komuniteti dhe zyrtarët komunal janë më të vetëdijshëm se burrat dhe gratë duhet të marrin pjesë në proces. Projekti ka bërë të mundur ndriçimin publik për më shumë siguri. Vendet e pjerrëta janë transformuar në rrugë për këmbësorë që nënat me fëmijë të lëvizin lehtë.

Mësimet e nxjerra: Komuniteti duhet të përfshihet prej fillimit. Gjuha e përdorur duhet të jetë më pak teknike në mënyrë që të kuptohet nga komuniteti. Fushata informuese për parandalimin duhet të përfshijë edhe komunikimin verbal/gojor pasi kjo është mënyra më e drejtpërdrejtë dhe efektive e marrjes dhe shkëmbimit të informacionit në komunitetet tradicionale. Në disa raste të veçanta, në nivel të lagjeve, gratë duhet të adresohen në mënyra të ndryshme, si për shembull nëpërmjet shoqatave të grave.

Rekomandimet/vëzhgimet: Nevojitet më shumë trajnim rreth çështjeve gjinore në planifikim, duke synuar në përfaqësuesit qeveritar dhe joqeveritar lokal. Duhet të organizohen stërvitje për fatkeqësitë dhe integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e saj. Fushatat e informimit dhe trajnimet mbi përkatësinë gjinore në administrimin e rrezikut të fatkeqësive duhet të promovohet në mënyrë që të rrisë vetëdijësimin e të dy gjinive në këtë fushë. Janë të nevojshme më shumë fushata sensibilizuese për përfshirjen e komunitetit.

Titulli i projektit:**Planifikimi i Lëvizshmërisë – MOBKOS, Lëvizshmëria Urbane në Kosovë****Lokacioni/Komuna:**

Peja

Viti i zbatimit:

2010-2014

Burimet buxhetore:

Qeveria Flamande, Belgjikë; Komuna e Pejës; MuSPP/ UN-Habitat-i

Partnerët kyç të zbatimit:

Komuna e Pejës; MobKos; OJQ-ja Syri i Vizionit; BE

Përfituesit e synuar:

Profesionistët; akademikët; shoqëria civile; publiku i përgjithshëm

Objektivat kryesore: Projekti kishte si qëllim testimin e një kornize për një program të lëvizshmërisë në Kosovë, duke përfshirë edhe perspektivën gjinore në lëvizshmëri dhe transport.

Përmbledhja e projektit: Komuna e Pejës ka vendosur në nivelin e PZHK-së qëllimin që të bëhet një “qytet vital dhe i gjelbër” në Kosovë, duke integruar zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e mënyrës aktive të jetës. Për të vazhduar këtë ambicie, komuna e Pejës ka investuar në planifikimin hapësinor dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane. Rehabilitimi i Korzos së Pejës (komuna/MuSPP) shërbeu si një pikënisje për planin e lëvizshmërisë lokale. Projekti prezantoi qasjen e kufizuar për makina në qendër të qytetit dhe një politikë parkimi me ndryshime në kohë dhe hapësirë për banorët dhe vizitorët. Projekti MOBKOS lehtësoi një programim më të mirë të aktiviteteve të ardhshme në lidhje me qasjen dhe lëvizshmërinë e integruar në nivel lokal, duke promovuar modele alternative të lëvizshmërisë.

Aktivitetet specifike në integrimin gjinor: Fushatat në lidhje me transportin publik u promovuan nga MOBKOS në bashkëpunim me OJQ-në Syri i Vizionit dhe në konsultim me komunën. Fushata e parë u mbajt në vitin 2009, bazuar në praktikën e njohur evropiane si ‘dita e ngasjes së biçikletës’. Më shumë se 300 pjesëmarrës morën pjesë. Mesazhi i sponsorizuar u shpërnda në mënyrën e duhur edhe përmes stendave të reklamimit të mëdha dhe të vogla dhe mesazhet e ndryshme në fletushka për të gjitha moshat dhe gjinitë. Fushatat e mëtejshme ndryshonin

në masë të madhe nga e para dhe u bazuan në vende të veçanta dhe u promovuan në mënyrë dominuese nëpërmjet rrjeteve sociale. Temat ishin parkingu ligjor, hapësira publike në qytet, çiklizmi dhe promovimi i Pejës si një qytet për këmbësorët, si dhe përfshirja e palëve të interesuara lidhur me ekonominë, tregtinë dhe kujdesin shëndetësor.

Rezultatet kryesore në lidhje me objektivat dhe çështjet gjinore të mbuluara:

Çështjet gjinore u mbuluan sepse si burrat ashtu dhe gratë ishin të përfshirë në ngritjen e kriterëve të dizajnit/projektimit, si dhe gjatë zbatimit të ideve. Nocioni i «hapësirës së përbashkët» dhe «performancës në rrugë» është një traditë në Pejë dhe një pasuri për qytetin dhe ishte e këshillueshme marrja e masave për të ruajtur këtë kulturë. Projektet e investimeve kapitale janë realizuar si rezultat i planit lokal të lëvizshmërisë duke përfshirë këtë nocion - p.sh. Bulevardi i Gjelbër Zatra, i zbatuar nga MuSPP-i në vitin 2013, si dhe Projekti i BE-së «projekti i qasjes në luginën e Dukagjinit & Rugovës» e cila përfshinë një shteg rekreativ që rrethon Pejën.

Ndikimi të komunitetave dhe / ose institucionet:

Hapësirat e përbashkëta e përforcojnë jetesën tradicionale të komunitetit, integrimin e mundësive për të gjitha grupet sociale në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Mësimet e nxjerra: Është shumë e rëndësishme që komuniteti dhe vendimmarrësit të përgatiten paraprakisht përmes aktiviteteve të ndryshme të vetëdijesimit.

Rekomandimet/vëzhgimet: Integrimi gjinor të merret parasysh në përgatitjen e planeve të detajuara, dizajnimin e hapësirave publike dhe shtigjeve për këmbësorë, si dhe në transport, lëvizshmëri dhe në projektet e sektorëve të tjerë të veçantë.

Titulli i projektit:**Oborret e qëndrueshme të shkollave****Komunat:**

Graçanicë; Hani i Elezit; Junik; Mamushë; Rahovec.

Viti i zbatimit:

2012-14

Partnerët kyç të zbatimit:

Komunat; MuSPP/ UN-Habitat-i; OJQ-të; Komuniteti; Shkollat

Përfituesit e synuar:

Stafi dhe nxënësit e shkollave; stafi i komunës; të gjithë anëtarët e komunitetit



Projekti Kapital Investiv, Parku Moronica- Komuna e Junikut
© UN-Habitat, Zyra në Kosovë

Objektivat kryesore: Objektivi i përgjithshëm është krijimi i një modeli të prekshëm të projektit nëpërmjet një sërë veprimesh të zhvilluara në mënyrë pjesëmarrëse, e cila do të sigurojë vende të sigurta dhe tërheqëse për rekreacion, mësim dhe argëtim. Projekti ka për qëllim të ofroj për stafin e shkollës, nxënësit dhe komunitetin, një ambient të këndshëm dhe të sigurt për rekreacion dhe argëtim, si dhe të rris vetëdijesimin për mirëmbajtjen e tij. Projekti promovon përfshirjen e të gjitha palëve të interesit prej planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të projektit e deri te mirëmbajtja e tij në të ardhmen.

Qëllimi është që oborri duhet t'i shërbejë lagjes si një hapësirë për komunitetin në zhvillimin e aktiviteteve të tilla si takimet publike, aktivitetet kulturore, kopshtarisë, dhe objektet rekreative. Shkollat nuk duhet t'i shërbejnë vetëm nxënësve të saj, por edhe të sigurojnë një vend të përshtatshëm dhe me vlerë për çdo anëtar të komunitetit.

Përmbledhja e projektit: Përmirësimi i oborreve të shkollave është përzgjedhur si prioritet i zhvillimit të identifikuar nga komuna të ndryshme partnere të MuSPP-it përmes procesit të planifikimit pjesëmarrës komunal. UN-Habitat-i propozoi një model të ri për përmirësimin e shkollës dhe angazhimit qytetar për të nxitur balancimin mjedisor, mjedise dinamike të të mësuarit. Qasja “oborr i qëndrueshëm” iu ofron nxënësve një vend për të mësuar dhe biseduar, një oborr që nxit përfshirjen dhe ndjenjën e të pasurit një vend. Oborret e qëndrueshme të shkollave gjithashtu ofrojnë mundësi për të mësuar në lidhje

me natyrën, ndërsa përmirëson kushtet në shkolla duke zhvilluar mësimin në natyrë, hapësira për aktivitete fizike, lojë, sporte dhe rekreacion, duke marrë parasysh nevojën për mirëmbajtjen e ulët të hapësirave publike.

Rezultatet kryesore: Procesi i pjesëmarrjes ka nxitur angazhimin e komunitetit dhe gjithëpërfshirjen, duke pasur parasysh grupet e pakicave, duke ndihmuar në nxitjen e balancës gjinore përmes angazhimit të mësuesve, grave dhe vajzave në procesin e dizajnit, dhe në veçanti, promovimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve. Në komunën e Rahovecit, procesi ka përfshirë një konkurs shkollor të hapur për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme. Konkursi ka pasur për qëllim zgjerimin e angazhimit publik dhe ngritjen e vetëdijes qytetare në mesin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve. Përveç krijimit të një “oborr të qëndrueshëm në shkollë” projekti synon të angazhojë komunitetin e shkollës në punën në ekip, për të rritur imagjinatën e nxënësve për çështjet urbane dhe ngritjen e vetëdijes për mjedisin. Projekti ka rezultuar të jetë i suksesshëm edhe në trajtimin e mungesës së burimeve komunale, përkatësisht tokës së kufizuar në dispozicion për investimet në hapësirat publike dhe mekanizmat për adresimin e mirëmbajtjes së hapësirave publike.

Ndikimi te komunitetet dhe / ose institucionet: Projekti ka ngritur vetëdijen në qeverisjen lokale dhe kontributin e mëtejshëm të komunitetit në zhvillimin e ardhshëm të projekteve në mënyrë pjesëmarrëse.

Mësimet e nxjerra: Nxënësit, mësuesit dhe prindërit e të dy gjinive morën pjesë në garat shkollore, punëtoritë dhe prezantimet publike, me përjashtim të një komune, ku morën pjesë vetëm baballarët, duke treguar se ka ende nevojë për ngritjen e aktiviteteve rreth vetëdijes në atë komunë të veçantë rurale. Mësueset, nënat dhe nxënëset si dhe gratë e stafit komunal mund të kenë një rol udhëheqës në proceset që lidhen me oborret e qëndrueshme të shkollave të cilat mund të jenë një faktor përsëritës.

Rekomandimet/vëzhgimet: Planifikimi, projektimi/dizajni urban dhe zbatimi i projektit përmes qasjes pjesëmarrëse do të inkurajoj gratë që të jenë aktive edhe në veprimtaritë e tjera komunale.

Në rastin specifik të Mamushës në mënyrë që të ketë gra të pranishme në aktivitete, sugjerohet organizimi i takimeve të veçanta apo diskutime vetëm me gra. Fokus grupet mund të jenë të ndara në baza gjinore në disa prej komuniteteve. Është shumë e rëndësishme gjatë angazhimit të përdoren forma të ndryshme, si pyetësorë ose organizimin e takimeve gjatë fundjavës për ata/ato që nuk mund të marrin pjesë gjatë ditëve të punës, me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes dhe adresimin nevojave të të gjithëve.

Titulli i projektit:

Korridori i Gjellbër i Lumit Lushta

Lokacioni/Komuna:

Pjesa urbane e lumit Lushta, e cila mbulon ri-projektimin/dizajnimin e kryqëzimit Selaci/Teutë dhe shtratit të lumit

Viti i zbatimit: 2011

Partnerët kyç të zbatimit:

Komuna e Mitrovicës; MuSPP/UN-Habitat-i; OJQ-të; Komuniteti

Përfituesit e synuar:

Një koordinim i organizatave të shoqërisë civile të udhëhequr nga "Little People of Kosova", duke përfshirë organizatat e grave, të moshuarve dhe të paafteve për të lëvizur; klasa e menaxhimit të trafikut në Shkollën e Mesme Teknike "Arkitekt Sinani"; publiku i gjerë i mobilizuar përmes një grupi të dedikuar në facebook; pronarët dhe qiramarrësit e pasurive të patundshme dhe dyqaneve në zonën e projektit

Objektivat kryesore: Objektivi i përgjithshëm ishte dhënia e një kontributi vendimtar në krijimin e konceptit "korridori i gjellbër" i lumit Lushta duke

përmirësuar funksionalitetin në rrjedhën e lumit Lushta përmes:

- Përmirësimin të hapësirës publike ekzistuese në qytet
- Mbrojtjes së peizazhit dhe rritjes së cilësisë/atraktivitetit përgjatë brigjeve të lumit
- Ndërtimit të një rrjeti për trafikun e ngadalshëm (këmbësorëve, çiklistëve, ..)
- Mundësimin të lëvizshmërisë për të gjithë (të rinj, të moshuar, me të meta, këmbësorët, çiklistët, përdoruesit e transportit publik, përdoruesit e makinave private ...)

Përmbledhja e projektit: PZHK-ja e Mitrovicës përfshinë planin për të zhvilluar «korridoret e gjellbëra» përgjatë lumenjve që kalojnë në qytet. Zonat përgjatë lumenjve do të kenë një shumëllojshmëri të funksioneve si shtigjet e transportit jo të motorizuar, objektet për kohën e lirë, vendet me theks në biodiversitet dhe rregulluesit e atmosferës urbane. Problemet dhe propozimet që dolën nga Punëtorja e Auditimit të Zonës – ushtrimi për rrugëtimin (walkabout) dhe planifikimin e zonës së lumit, e ka përshkruar vizionin për këtë zonë si një hapësirë urbane të gjellbër dhe lidhje transporti jo të motorizuar me qendrën e qytetit për një pjesë të zgjeruar të qytetit - Vaganica. Në veçanti, qëllimi ishte për të ofruar hapësira publike të cilësisë më të mirë për rekreacion në një mjedis të pastër dhe të gjellbër. Dizajnimi i projektit u përpunua në një seri të punëtorive pjesëmarrëse dhe përfshin një numër të përmirësimeve që janë bërë përmes dizajnit urban: rruga e shtruar, pamja, ndriçimi, gjellbërimi, lidhja e shtrirjes së rrugëve, rrugë për këmbësor koherente - pa pengesa, vendet për pushim për këmbësorë, soditje të peizazhit, pajisja e rrugëve (me pemë, stola, të mbjellura, kosha për mbeturina).

Rezultatet kryesore në: Përmirësimin e situatës në terren që janë arritur kryesisht nga ndërhyrjet fizike në infrastrukturën e trafikut dhe hapësirës publike të lokacionit të projektit duke bërë të mundur:

- Sigurimin dhe lehtësimin e rrjedhës së trafikut nëpër kryqëzim
- Përfitim dhe përmirësimin e hapësirës publike
- Lidhjen në mënyrë efektive të korridorit të gjellbër me rrugët e qendrës së qytetit dhe itineraret të këmbësorëve

Ndikimi në komunitete dhe / ose institucionet:

Mjedi urban i lumit Lushta është bërë një hapësirë tërheqëse publike, duke ju ofruar banorëve dhe kalimtarëve të rastit hapësira publike më të larmishme

që lejojnë lëvizshmëri më të mirë dhe gjithashtu ndërveprim social. Në zhvillimin e këtij PIK-u, stafi komunal ka ushtruar procesin e gjerë pjesëmarrës në dizajnimin e ambientit miqësor dhe me qasje që do të plotësojë nevojat e të gjithë banorëve të qytetit.

Mësimet e nxjerra: Përfshirja dhe pjesëmarrja e personave me nevoja të veçanta dhe grupit të punës me balancë gjinore në Auditimin e Hapësirës për këmbësorë, në vendin e projektit ishte shumë e rëndësishme, sepse ajo e ka ngritur vetëdijen në mesin e pjesëmarrësve për rëndësinë e një projekti gjithëpërfshirës.

Auditimi ka siguruar reagime të dobishme në lidhje me çështjet e qasjes, veçanërisht në lidhje me të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe solli në vëmendje respektimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2001/19 për kushtet teknike, për objektet e ndërtimit në lidhje me qasjen e personave me aftësi të kufizuara. Këto të dhëna ishin të rëndësishme për grupin teknik të punës.

Rekomandimet/vëzhgimet: Komuna duhet të maksimizoj replikimin e qasjeve dhe aktiviteteve të përdorura në projekt për të siguruar mobilizimin e duhur të shoqërisë civile për projektet e ardhshme të ngjashme. Një strategji më e gjerë e komunikimit duhet po ashtu të krijohet nga komuna për të përgatitur përsëritjen/shtrirjen për projekte të tjera në Mitrovicë dhe gjetiu.

Titulli i projektit:

Revitalizimi i rrugës së Farkëtarëve

Lokacioni /Komuna:

Qendra historike e Prizrenit

Viti i zbatimit:

2009/2010

Burimi buxhetor:

Bashkë financim me Komunën
Partnerët kyç të zbatimit: Komuna e Prizrenit;
MuSPP/UN-Habitat-i

Përfituesit e synuar:

Banorët e zonës së PIK-ut, duke përfshirë komunitetin më të gjerë të Qendrës Historike; Bizneset e vogla / mikro-ndërmarrjet në zonën e PIK-ut

Objektivat kryesore: Përmirësimi i lidhjes; maksimizimi i sigurisë; krijimi i një mjedisi për bizneset e vogla; ofrimi i mundësive për qytetarët që të shprehin veten e tyre.

Përmbledhja e projektit: Zyra e MuSPP-it në Prizren së bashku me komunën kanë hartuar udhëzime për zhvillimin e Qendrës Historike dhe si rezultat, kanë rënë dakord për të identifikuar, projektuar/dizajnuar dhe zbatuar një PIK brenda Qendrës Historike. Pas konsultimeve të thella me qytetarët përmes një Auditimi të Zonës, rruga e Farkëtarëve u zgjodh si zonë për projektin. Propozimi i projektimit të projektit u ndërmor në mënyrë sekuenciale bazuar në gjetjet nga Auditimi i Hapësirës në përputhje të projektit me planin e ruajtjes, si dhe menaxhimin e trashëgimisë inovative dorëzuar nga ekipi teknik i ngritur në komunë.

Auditimi i Hapësirës ndihmoi në identifikimin e elementeve të projektit. Gratë dhe burrat kishin pothuajse të njëjtat kërkesa dhe prioritetet por të renditura ndryshe. Megjithatë, gratë pjesëmarrëse theksuan përmirësimin e dizajnit publik të zonës. Sugjerimet dhe rekomandimet janë përdorur nga ekipi teknik për dizajnin përfundimtar të projektit.

Rezultatet kryesore: Përmirësimi i pamjes së rrugës duke e bërë atë vetëm për këmbësorë; pajisja e rrugës me mjetet e përshtatshme për gratë dhe fëmijët; shenjzimi dhe ndriçimi efektiv; riorganizimi i hapësirës së hapur për tubime, përfshirë gjelbërimin rreth shtëpisë së kulturës dhe para kinemasë; krijimi i rrugës së gjerë për ecje në këmbë duke filluar nga ura e gurit; largimi i vend-parkimit kaotik dhe përcaktimi i një përshkrimi të qartë të zonave të parkimit; përmirësimi i ndërveprimit me sheshin kryesor të qytetit «Shadërvan».

Projekti ka bashkëpunuar për të ndërtuar një lidhje të mirë në mes të shoqatave të grave, profesionistëve dhe anëtarë të tjerë të komunitetit të zonës së projektit përmes përfshirjes së tyre aktive dhe kontributit në takimet konsultative të projektit dhe auditimet e hapësirës.

Ndikimi te komunitetet dhe/ose institucionet:

Kjo shkaktoi hapjen e bizneseve të reja të vogla dhe përmirësimin e kushteve të atyre ekzistuese; vënia në pah e ndërtesave kulturore dhe vetë rrugës duke i bërë ato më tërheqëse për vizitorët sidomos krijimi i ndërveprimit me vizitorët e Shadërvanit; rritja e vetëdijes së zyrtarëve komunal për zbatimin e PIK-ut përmes pjesëmarrjes publike gjithëpërfshirëse.

Mësimet e nxjerra: Rezultatet e projektit do të jenë më të qëndrueshme kur në proces përfshihen grupe të ndryshme gjinore (grupmosha të ndryshme, si dhe prej fushave të ndryshme, grupet e interesit, etj).

Rekomandimet / vëzhgimet: Analiza e palëve të interesit në aspektin gjinor gjatë fillimit të projektit është thelbësore.

4. MËSIMET E NXJERRA DHE REKOMANDIMET PËR INTEGRIMIN GJINOR NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

“Fuqizimi i grave për të marrë pjesë plotësisht në jetën ekonomike në të gjithë sektorët është thelbësor për ndërtimin e ekonomive më të forta, për të arritur qëllimet e pranuar ndërkombëtarisht për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë, dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së grave, burrave, familjeve dhe komuniteteve.”²³

Është e rëndësishme të sigurohemi që proceset e zhvillimit të ndikojnë pozitivisht dhe të forcojnë barazinë gjinore. Qëllimi i qasjes gjinore në planifikimin hapësinor është që të garantojë që gratë dhe burrat do të kenë rolet përkatëse, përgjegjësitë e barabarta, qasje dhe mundësi në proceset e zhvillimit, si në nivel qendror ashtu edhe lokal, dhe do të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ndërhyrjet strategjike të zhvillimit.

Rritja e pjesëmarrjes në sektorin e planifikimit hapësinor dhe shërbimeve publike është e nevojshme, duke aplikuar praktikën e mira nëpër nivele të ndryshme të qeverisjes dhe përmirësimin e partneriteteve të duhura në arritjen e zhvillimit të suksesshëm përfshirës hapësinor, duke përfshirë edhe kujdesin për sektorë të veçantë të tillë si banim të përbalueshëm apo planifikim të lëvizshmërisë. Aktivitetet specifike për promovimin e përbërjes gjinore në planifikimin hapësinor mund të përfshijnë fushatat e ndërgjegjësimit dhe përmirësimin e kapaciteteve të stafit lokal dhe përfaqësuesve që punojnë në këtë fushë, organizimi i trajnimeve të veçanta, takimeve, debateve publike,

publikimeve të ndryshme, hulumtimeve, buxhetimit gjinor, etj. Roli kyç i këtij procesi është që të rrisë vetëdijësimin dhe ngritjen e kapaciteteve në mesin e komunitetit profesional (planerëve, arkitektëve dhe vendimmarrësve) në lidhje me rëndësinë e integritit gjinor. Identifikimi i *kurrikulave* të duhura për integrimin e studimeve gjinore në diplomatat e Arkitekturës dhe Planifikimit do të ishte relevante.

SFIDAT

Që ky proces i zhvillimit të barabartë gjinor të jetë i suksesshëm në Kosovë, disa sfida dhe pengesa të identifikuar duhet tejkaluar dhe këto përfshijnë mungesën e kapacitetit të burimeve njerëzore, mungesa e rregulloreve mbi monitorimin dhe zbatimin, aspektet kulturore, të cilat mund për shembull të ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e përgjithshme të grave në ngjarjet publike, mungesa e të dhënave përkatëse për analizë, dhe mungesa e normave teknike në Planifikimin Hapësinor²⁴.

²³ UN-Habitat, 2012a, A compendium of case studies on gender mainstreaming initiatives, Nairobi: UN-Habitat

²⁴ Këto të fundit janë duke u rishikuar nga MMPH me mbështetjen e MuSPP-it/ UN-Habitat-it dhe duhet të jenë në dispozicion për publikun e gjerë gjatë vitit 2014

MËSIMET E NXJERRA

Rastet e paraqitura në këto udhëzime janë një burim për t'u bazuar në to. Edhe pse ato mund të jenë optimiste për sa i përket ndikimit të tyre në barazinë gjinore dhe potencialit fuqizues të grave, çështjet gjinore të mbuluara dhe procesi i integritit të tyre janë nga mësimet më të udhëzuara.

Në mesin e mësimëve të përbashkëta nga këto raste studimore vihen re aspektet e mëposhtme:

Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja

- Integrimi i perspektivës gjinore në vendbanimet njerëzore mund të arrihet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të të gjitha palëve të interesuara - gratë, burrat, vajzat dhe djemtë - duke filluar nga një fazë e hershme e procesit të planifikimit. Angazhimi i të dy gjinive do të sigurojë që nevojat e tyre të veçanta të adresohen;
- Pjesëmarrja e palëve përkatëse të interesuara siguron qëndrueshmërinë kur ata janë direkt të përfshirë në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Duhet marrë parasysh gjetja e mënyrave alternative për të përforcuar pjesëmarrjen, të tilla si nëpërmjet garave shkollore, festivaleve, apo aktiviteteve të tjera të bazuara nëpër lagje që janë të afërta me komunitetet lokale;
- Mbështetja në përvoja dhe tradita lokale është një mënyrë e qëndrueshme për të siguruar integrimin gjinor në aktivitetet e planifikimit hapësinor. Është, pra, e rëndësishme për të siguruar një kuptim të saktë të cilësive lokale dhe manifestimeve hapësinore para hyrjes në aktivitetet e veçanta me komunitetet lokale;
- Partneritetet me qeverisjet lokale, organizatat e përfituesve me bazë në komunitet (OBK/CBO) (gratë, burrat, të rinjtë dhe të moshuarit), organizatat jo-qeveritare, organizatat e biznesit privat, grupet e shoqërisë civile, sektorit të arsimit, agjencive qeveritare dhe sektorëve të tjerë si planifikimi mjedisor do të përforcojnë suksesin e strategjive lokale për të arritur barazinë gjinore;
- Ekziston nevoja për përforcimin e veprimit dhe aktiviteteve të fokusuara duke synuar tek grupet më në nevojë, si ato në komunitetet rurale. OJQ-të lokale kanë luajtur një rol të rëndësishëm në raste të tilla, por motivimi është i nevojshëm në mënyrë që këto organizata të ndjekin punën e tyre.

Mjetet për një perspektivë gjinore në proces

- Baza e zbërthimit gjinor dhe monitorimit të të dhënave, si dhe analizat gjinore janë një bazë e fortë që do të udhëheq përsosjen e dizajnit të projektit dhe zbatimin e tij; si dhe për monitorimin periodik të progresit dhe rezultateve;
- Auditimet e zonës/anketimet në terren janë mjete të rëndësishme për të siguruar një kuptim të saktë të nevojave specifike të grupeve të ndryshme sociale dhe mund të jenë një burim i rëndësishëm i hartimit të një propozimi që do të adresojë në mënyrë efektive nevojat e të gjithë qytetarëve;
- Kur kemi të bëjmë me hapësirat publike, barazia gjinore është thelbësore, si një objektivi, dhe si një tregues i një hapësire të suksesshme.

Vetëdijesimi dhe ngritja e kapaciteteve

- Trajnimi gjinor në planifikim duke synuar përfaqësuesit e qeverisë lokale dhe jo-qeveritare, fushatat e informimit dhe trajnimet mbi përkatësinë gjinore në fusha të ndryshme tematike (për shembull të menaxhimit të rrezikut të fatkeqësive) duhet të promovohet në mënyrë që të risë vetëdijesimin e të dy gjinive. Janë të nevojshme më shumë fushata vetëdijësuese për përfshirjen e komunitetit.
- Menaxhmenti i projektit dhe stafi janë çelës në integrimin e perspektivave gjinore në planifikimin hapësinor dhe duhet të jenë të trajnuar, në mënyrë që të përfshijnë plotësisht konceptet dhe çështjet bazike gjinore, dhe të kuptojnë ndikimin e projekteve tek burrat dhe gratë si dhe nevojën për të reaguar në mënyrë të duhur.

REKOMANDIMET

Për të arritur integrimin gjinor në nivel lokal dhe qendror rekomandohet që të merren parasysh aspektet e mëposhtme gjatë procesit të planifikimit:

Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja

- Inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet dhe fazat e procesit të planifikimit, duke i përfshirë edhe ato në pozita vendim-marrëse;
- Përfshirja e pjesëmarrjes së grave në konsultime publike, punëtori dhe takime të tjera;
- Marrja e hapave aktivë për të siguruar që të gjitha palët e interesuara janë të informuar;
- Hartimi i një liste kontrolluese gjinore të pjesëmarrjes publike dhe kontributi i tyre në politika dhe plane;

Mjetet për një perspektivë gjinore në proces

- Përforcimi i qasjes gjinore duhet të merret parasysh në të gjitha fazat e zhvillimit të politikave dhe zbatimit, vlerësimit dhe aktiviteteve të bashkëpunimit teknik;
- Marrja në konsideratë e përbërjes së organeve të planifikimit në aspektin gjinor;
- Pasqyrimi i strategjive organizative për barazi gjinore në projekte / programe / objektiva dhe buxhet;
- Sigurimi që të gjitha dokumentet e planifikimit e marrin në konsideratë perspektivën gjinore. Dokumentet e planifikimit duhet të përfshijnë një kapitull mbi procesin, i cili përshkruan përfshirjen e palëve të interesuara (burrave dhe grave) dhe mjetet e përdorura për të mbledhur opinionet dhe inputet (analizat e palëve të interesuara, të dhënat e zbërthyer gjinore, takimet, anketat e opinionit, punëtoritë e vizionimit, grupet punuese, etj). Një pilot projekt për planifikimin hapësinor me ndërhyrje specifike gjinore mund të konsiderohet si një referencë;
- Integrimi i analizës gjinore si një mjet gjatë procesit të planifikimit hapësinor, që përfshinë veprimtari të tilla sikurse analiza të palëve të interesuara dhe diagnoza urbane. Kjo përfshinë identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave të zbërthyer gjinore;
- Tregues të veçantë duhet të përcaktohen si bazë për monitorimin e arritjeve, mundësisht të ndërlikuar me objektiva të sektorëve tjerë, për shembull për klimën dhe energjinë. Kur është e mundur, treguesit duhet të zhvillohen përmes një procesi me pjesëmarrje, i cili do të ndihmojë për të siguruar që ata janë të rëndësishëm për realitetin e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, në çdo situatë. Profili gjinor i Kosovës i kohëve të fundit ofron një burim të shkëlqyer të informatave, duke përfshirë edhe identifikimin e akterëve kyç dhe të dhënave të zbërthyer përkatese gjinore për nivelin qendror dhe lokal.

Vetëdijesimi dhe ngritja e kapaciteteve

- Zhvillimi i ngritjes së kapaciteteve dhe programet e trajnimit lidhur me çështjet gjinore dhe çështjet gjinore në planifikim. Të sigurohet që një program i veçantë trajnimi është mbajtur për nivelet udhëheqëse, duke synuar gjithashtu që të zhvillojnë më tej programe të veçanta në sektorë të ndryshëm komunal.

KONKLUZIONE

Planifikimi i gjithmbarshëm i qytetit është niveli më i rëndësishëm për të vendosur drejtimit e politikës lidhur me planifikimin e ndjeshëm gjinor. Kategoritë e integritit të sektorëve për përfshirjen e qasjeve sektoriale të veçanta janë thelbësore për zbatimin e integritit gjinor, plotësimi i ambicieve të përgjithshme të planifikimit hapësinor në fusha të veçanta të sektorit siç janë: lëvizshmëria, banimi, shërbimet ose hapësira publike.

Integrimi gjinor ka për synim përmirësimin e përgjithshëm të kushteve sociale të të dyja gjinive. Megjithatë, duhet theksuar se një proces i tillë nuk duhet të jetë shkatërrues i traditave lokale, por më tepër për të ndërtuar mbi to dhe për të përforcuar praktikatat ekzistuese sociale që mund të jenë pozitive për të ndjekur qëllimin e barazisë gjinore.

Planerët e autoriteteve lokale kanë një rol kyç në sigurimin që barazia gjinore të merret parasysh gjatë procesit të planifikimit. Partneritetet përkatëse të planifikimit duhet që të nxiten me organizatat-bazë dhe ekspertë të tjerë gjinor për të kuptuar më mirë çështjet dhe nevojat e grupeve të ndryshme të njerëzve që lehtësojnë integrimin gjinor në fusha të

veçanta sektoriale. Partneritetet efikase gjithashtu do të sigurojnë një bazë solide për të mbështetur vazhdimin dhe zbatimin efikas të proceseve të planifikimit, si dhe mundësojnë qasje kreative për integrim gjinor në nivel lokal.

Komunat e Kosovës kanë nevojë për një model të qëndrueshëm për planifikim hapësinor i cili do të trajtojë trendët kryesore të urbanizimit, ndryshimet klimatike dhe rritjen ekonomike. Në mënyrë që ky brez i ri i planifikimit hapësinor të ketë sukses dhe qytetet dhe komunat e Kosovës të jenë më përfshirëse dhe të balancuara, është thelbësore që planerët lokal dhe vendim-marrësit të përfshijnë një qasje të perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit dhe në çdo nivel të planifikimit. Vullneti politik është kritik në këtë proces. Politikat dhe planet në vetvete nuk mund të jenë efektive nëse mungon vullneti për zbatim. Strategjitë e zbatimit, ngritja e kapaciteteve, burimet e dedikuara, si dhe mekanizmat e monitorimit dhe përgjegjshmërisë janë pjesë përbërëse e procesit që do të ndihmojë në institucionalizimin dhe promovimin e barazisë gjinore në Kosovë dhe qasjes së barabartë në qytet.

REFERENCAT

- Bridge (2007), *Gender Indicators: What, Why and How?*
- Në dispozicion në: <http://www.oecd.org/social/gender-development/43041409.pdf> (qasur së fundi: 2014/5/23)
- Cozzarelli, C. (2012), *Kosovo Gender Assessment*, Pristina: USAID/Kosovo
- Färnsveden, U.; Qosaj-Mustafa A; Farnsworth, N. (2014), *Profili Gjnor i Vendit*, Stokholm: ORGUT consulting
- Hannan, C. (2003), *Gender mainstreaming: Reflections on implementation of the strategy*, prezantuar në seminarin për Integrimin e barazisë gjnore në bashkëpunimin për zhvillim, organizuar nga Komisioni Evropian dhe SIDA
- Hunt, A. and Undurraga, R. (2009), *From Rhetoric to Reality: A Critical Analysis of the National Action Plan for the Achievement of Gender Equality in Kosovo. Studies in Ethnicity and Nationalism*, 9, f. 49-69.
- Qendra Kosovare për Studime Gjnore (2011), *Të drejtat e grave mbi trashëgiminë e pronës në Kosovë*, Prishtinë: QKSGJ
- Neimanis, Astrida (2002), *Gender Mainstreaming in practice: a Handbook*. Bratislava: UNDP Regional Centre for Europe.
- Royal Town Planning Institute (2003), *Gender Equality and Plan Making: The Gender Mainstreaming Toolkit*, London: RTPI
- Todes, A.; Malaza N. and Williamson, A. (2009), *Good Practice in Planning with Gender in the Commonwealth*. Paper for the Women in Planning (WiP) Network of the Commonwealth Association of Planners, March 2009
- UNCTAD/UNDP, *Mainstreaming gender into trade and development strategies in Africa. Trade negotiations and Africa series: no. 4*, United Nations, New York and Geneva, 2008
- UN-Habitat (2013), *State of women in cities 2012-2013: gender and the prosperity of cities*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2012a), *A compendium of case studies on gender mainstreaming initiatives*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2012b), *Gender Issue Guide: Urban Planning and Design*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2012c), *Gender Issue Guide: Housing and slum upgrading*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2012d), *Gender and Urban Planning*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2012e), *Visioning as participatory planning tool: learning from Kosovo practices*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2011), *Global Report on Human Settlements 2011. Cities and Climate Change: Policy Directions*, Abridged edition, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2010a), *State of the World's Cities 2010/2011: Bridging the Urban Divide*, London: Earthscan
- UN-Habitat (2010b), *Gender Equality for Smarter Cities: Challenges and Progress*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2010c), *Planning sustainable cities: UN-Habitat practices and perspectives*, Nairobi: UNON
- UN-Habitat (2009), *Gender approach in municipal spatial planning*, Pristina: UN-Habitat Kosovo
- UN-Habitat (2008a), *Factsheet: Gender and Safety and Security in Cities*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2008b), *Gender Equality for a Better Urban Future: An Overview of UN-Habitat's Gender Equality Action Plan (2008-2013)*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2008c), *Gender mainstreaming in local authorities: Best practices*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2007a), *Policy Makers Guide to Women's Land, Property and Housing Rights Across the World*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2007b), *Inclusive and sustainable urban planning: a guide for municipalities*, vols. 1-5, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2006), *Women's Equal Rights to Housing, Land and Property in International Law*, Nairobi: UN-Habitat
- UN-Habitat (2003), *Toolkit for Mainstreaming Gender in UN-Habitat Field programmes*, Pristina: UN-Habitat Kosovo
- Walby, S. (2005), *Gender Mainstreaming: Productive Tensions in Theory and Practice. Social Politics: International Studies in Gender, State and Society*, Volume 12, Number 3, pp. 321-343

SHTOJCA 1: LISTA KONTROLLUESE E INTEGRIMIT GJINOR PËR DOKUMENTE TË PROJEKTIT APO TË POLITIKAVE

- **Historiku dhe Arsyetimi:** A është i theksuar dimensionimi gjinor në informatat rreth historikut tek ndërhyrjet e caktuara? A përfshinë arsyetimi argumente bindëse për integrimin gjinor dhe të barazisë gjinore?
- **Qëllimet:** A i pasqyron qëllimi i ndërhyrjes së propozuar nevojat e burrave dhe grave? A kërkon qëllimi që të korrigjojë pabarazitë gjinore përmes adresimit të nevojave praktike të grave dhe burrave? A kërkon qëllimi që të transformojë institucionet (sociale dhe të tjera) që përjetësojnë pabarazinë gjinore?
- **Përfituesit e Synuar:** Përveç në rastet ku ndërhyrjet në mënyrë specifike synojnë burrat ose gratë si masë korrigjuese për të rritur barazinë gjinore, a ekziston barazia gjinore në kuadër të grupit përfitues të synuar?
- **Objektivat:** A e adresojnë nevojën si të grave ashtu edhe të burrave objektivat e ndërhyrjeve?
- **Aktivitetet:** Aktivitetet e planifikuara a i përfshijnë burrat dhe gratë? A janë të nevojshme aktivitetet shtesë për të siguruar që perspektiva gjinore është e qartë (p.sh. trajnimet në çështjet gjinore, hulumtimet shtesë, etj)?
- **Treguesit:** A janë përcaktuar treguesit për të matur progresin drejt plotësimit të secilit objektivi? A matin këta tregues aspektet gjinore të secilit objektivi? A janë treguesit të zërthyer në aspektin gjinor? A janë vendosur synimet për të garantuar një nivel të mjaftueshëm të barazisë gjinore nëpër aktivitete (p.sh. kuota për pjesëmarrje të burrave dhe grave)?
- **Zbatimi:** Kush do të zbatojë ndërhyrjen e planifikuar? A kanë pasur këta partnerë trajnime për integrim gjinor, në mënyrë që perspektiva gjinore të mund të jetë e qëndrueshme përgjatë tërë zbatimit? A do të marrin pjesë gratë dhe burrat në zbatim?
- **Monitorimi dhe Vlerësimi:** A e përfshinë strategjia e vlerësimit dhe monitorimit perspektivën gjinore? A do të shqyrtojë si aspektin përmbajtjesor (përmbajtjen) ashtu edhe atë administrativ (procesin) të ndërhyrjes?
- **Rreziqet:** A është marrë parasysh konteksti më i madh i roleve gjinore dhe marrëdhëniet në shoqëri si një rrezik i mundshëm (p.sh. stereotipet/klishetë ose pengesat strukturore që mund të parandalojnë pjesëmarrjen e plotë të njërës ose tjetrës gjini)? A është marrë parasysh ndikimi i mundshëm negativ i ndërhyrjes (p.sh. mundësia për të rritur barrën mbi gratë apo izolimin social të burrave?)
- **Buxheti:** A është analizuar aspekti gjinor në inputet financiare për të siguruar që gratë dhe burrat do të përfitojnë nga ndërhyrja e planifikuar? A është caktuar në buxhet nevoja për të ofruar trajnim senzibilizues gjinor apo për të angazhuar ekspertë afatshkurtër gjinorë?
- **Shtojcat:** A janë të gjitha dokumentet përkatëse hulumtuese (ose fragmentet) të përfshira si shtojca (veçanërisht ato që japin arsyetim të shëndoshë për vëmendjen tuaj ndaj gjinisë)?
- **Strategjia e Komunikimit:** A është zhvilluar një strategji komunikimi për informimin e publikut të ndryshëm në lidhje me ekzistencën, progresin dhe rezultatet e projektit nga perspektiva gjinore?

Burimi:

Gender Mainstreaming in practice: a Handbook (2002). Bratislava: UNDP Regional Centre for Europe.

SHTOJCA 2: SHEMBULL I FORMULARIT TË VLERËSIMIT GJINOR

| FUSHA TEMATIKE SHEMBUJT | OPSIONET ALTERNATIVE | VLERËSIMI I NDIKIMIT GJINOR | |
|----------------------------|----------------------|-----------------------------|----------|
| | | FEMËR | MASHKULL |
| Qasja dhe Lëvizshmëria | Skenari 1 | -2 | 0 |
| | Skenari 2 | 1 | 1 |
| | Skenari 3 | 2 | 2 |
| | Skenari 4 | 0 | 0 |
| Banimi | Skenari 1 | 0 | 0 |
| | Skenari 2 | 1 | 1 |
| | Skenari 3 | -1 | 0 |
| | Skenari 4 | 0 | 0 |
| Shërbimet Publike | Skenari 1 | 1 | 1 |
| | Skenari 2 | 0 | 0 |
| | Skenari 3 | 1 | 1 |
| | Skenari 4 | 2 | 1 |
| Hapësirat Publike | Skenari 1 | 1 | 0 |
| | Skenari 2 | -2 | 0 |
| | Skenari 3 | 2 | 2 |
| | Skenari 4 | 1 | 1 |
| Arsimi... | Skenari 1 | 0 | -2 |
| | Skenari 2 | 2 | 0 |
| | Skenari 3 | 0 | 0 |
| | Skenari 4 | 0 | 0 |

NDIKIMI I LARTË NEGATIV

-2

NDIKIM I LEHTË NEGATIV

-1

BAZA

0

NDIKIM I LEHTË POZITIV

1

NDIKIMI I LARTËI POZITIV

2

SHKALLA E NDIKIMIT



SHTOJCA 3: SHEMBULL I MATRICËS SË ANALIZËS GJINORE

| Propozimi i Planifikimit | Çështjet relevante gjinore | Përgjigjet / opinionet e komunitetit | Implikimet Gjinore | Implikimet në Planifikim |
|---|---|---|--|--|
| Të zhvillohet një rrjet ekologjik koherent i qarkullimit jomotorik dhe zonave rekreative të natyrës | Kush ka qasje në rrjetin ekologjik dhe / ose zonat rekreative? | Të identifikohen nevojat, kërkesat dhe prioritetet e komunitetit (për shembull gjatë konsultimeve). | Më pak angazhim qytetar në veprimtari rekreative, implikimet e sigurisë. | Të shmangen propozimet e projektimit/ dizajnit që nxisin mjedise dhe sjellje të pasigurta. Të shikohet nëse dizajni urban i plotëson nevojat e përdoruesve. |
| Shërbimet e integruara parashkollore komunale | Kush çfarë bën? Cilat janë kushtet sa i përket qasjes në shërbime? | Informata/opinione mbi përgjegjësitë. Kontrolloni/shikoni kushtet e qasjes (koha e udhëtimit, kushtet e rrugëve, objekteve mbështetëse, oraret, etj) | Mungesa e qasjes në hapësirat parashkollore, implikimet e sigurisë, më pak mundësi punësimi. | Inkurajoni për një lokacion të duhur në Qendrën e Qytetit dhe konsideroni qasshmëri të duhur në këtë lokacion. Plani i Lëvizshmërisë duhet të analizohet në mënyrë paralele. |

Përshtatur nga Todes, A.; Malaza N. and Williamson, A. (2009), Good Practice in Planning with Gender in the Commonwealth. Paper for the Women in Planning (WiP) Network of the Commonwealth Association of Planners, March 2009, f. 13.



*Një grua duke dhënë mësim në lëndën e gjeometrisë: Një pikturë nga një përkthim mesjetar i veprave filozofike antike të vitit 1265-99. MS Burney 275, fo. 293. (Biblioteka Britanike) Ribotuar në *The Making of the Middle Ages*, R. W. Southern. London: The Folio Society, 1998. E drejta e autorit 1953. Ilustrimi pas f. 192.*

Të kuptuarit e nevojave dhe ndërveprimit të ndryshëm të grave dhe burrave është një bazë e vlefshme për vendim-marrësit, planerët, projektuesit dhe akterët tjerë në procesin e planifikimit hapësinor në mënyrë që ata të mund të analizojnë dhe të përfshijnë një perspektivë gjinore në formulimin e kornizave zhvillimore të cilat janë të përshtatshme në kontekstin shoqëror.

Këto udhëzime kanë për qëllim të ndihmojnë qeveritë e nivelit qendror dhe lokal, si dhe shoqërinë civile, duke ofruar një udhëzues hap- pas- hapi dhe rekomandime të përgjithshme, metoda dhe mjete se si të integrojnë aspektin gjinor në planifikimin hapësinor. Udhëzimet ofrojnë informacion të përgjithshëm mbi çështjet gjinore dhe të grave, duke synuar ofrimin e një burimi inspirues dhe një bazë për shkëmbim, mjete dhe programe për trajnim dhe ngritje të kapaciteteve, si dhe informata mbi formulimin e politikave dhe përgatitjen e programeve.

ISBN 978-9951-545-10-5



9 789951 545105